

Intervistë në emisionin televiziv “Open” me gazetaren Eni Vasili



Eni Vasili: Mendonit se do të ishte kaq e gjatë periudha e përkohshmërisë, që nga 18 Dhjetori 2017? Gati një vit e gjysmë.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Në fakt, përpara se ti përgjigjem kësaj pyetjeje, do të doja të bëja një retrospektivë, pra një kthim prapa, për të përmendur arsyet se pse u zgjodh Prokurori i Përgjithshëm i Përkohshëm. Në një nga ligjet pjesë të paketës së Reformës në Drejtësi, pikërisht në ligjin “Për Organizimin dhe Funëksionimin e Prokurorisë”, në një dispozitë kalimtare të këtij ligji parashikohej që nëse Këshilli i Lartë i Prokurorisë nuk do zgjidhej në kohë dhe gjatë kësaj periudhe mbaronte mandati i prokurorit që ishte në detyrë aso kohe, funëksionet e Prokurorit të Përgjithshëm do ti ngarkoheshin për ti kryer një nga prokurorët me më shumë eksperiencë, që kishte përfunduar shkollën e Magjistraturës apo që kishte një gradë shkencore në drejtësi; që kishte një eksperiencë punë mbi 15 vjet në sistemin e Prokurorisë dhe do të caktohej me vendim të Kuvendit, për të ushtruar funëksionet e Prokurorit të Përgjithshëm në mënyrë të përkohshme. Pra, ishte një dispozitë kalimtare që ishte vënë në legjislacion, për ti paraprirë një lloj ngërçi apo një lloj boshllëku ligjor që mund të krijohet nëse KLP do vononte të ngrihej.

Eni Vasili: Dispozitë e cila u shoqërua me debate, duhet ta kujtojmë nga opozita.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Patjetër. U shoqërua me debate.

Eni Vasili: Në mënyrë të veçantë.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Me debate, por është një dispozitë e

miratuar nga parlamentarët.

Eni Vasili: Po patjetër, po për cilën ka pasur interpretime të ndryshme, më pas.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Një dispozitë ligjore. Ligji është miratuar që në vitin 2016 dhe është naive të mendosh që dikush e parashikoi që e gjithë kjo do të ndodhte.

Ligji parashikonte afate të detajuara për ngritjen e insitucioneve dhe nëse do ishin respektuar afatet nuk do ishim me një Prokuror të Përkohshëm.

Eni Vasili: Sigurisht po edhe opozita në atë kohë thoshte pikërisht këtë: “Nuk e dimë se sa do të qëndrojë në detyrë”, e cila në fakt kërkonte që të zgjatej mandati i Kryeprokurorit të atëhershëm, po e perifrazoj sa më shkurt si ide pasi debatet kanë qenë të gjata. Duket sikur në fakt, opozita e atëhershme ka patur një lloj të drejte, pra përkohshmëria u zgjat disi. I jep të drejtë kjo opozitës?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Unë mund t’ju them që nuk e kam menduar për asnjë moment që përkohshmëria të zgjatej kaq shumë dhe do ta them pse nuk e kam menduar. Do shikoni që nuk ka një arsye në këtë mes. Në kohën që unë kandidova, kishin aplikuar të gjithë prokurorët që donin të ishin pjesë e KLP-së, pra kishte një garë të hapur. Të gjithë prokurorët kishin hyrë në Veting dhe kishte një dispozitë ligjore. Konkretisht është neni 279, pika 4 e ligjit “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit Drejtësisë” që parashikon se vetingu për Prokurorë që kandidojnë për të qenë pjesë e KLP-së, KLGJ-së do mbaronte brenda tre muajve, nga momenti që ishte paraqitur shprehja e interesit dhe dokumentet përkatëse. Pra tre muaj do zgjaste Vetingu. Brenda 3 ditëve nga mbarimi Vetingut, Prokurori i Përgjithshëm kishte detyrimin ligjor që të thërriste mbledhjen e Përgjithshme të Prokurorëve, për të bërë zgjedhjen e prokurorëve anëtarë të KLP-së dhe brenda 20 ditëve nga thirrja, mbledhja duhet të kishte përfunduar dhe anëtarët do ishin të zgjedhur. Pra po ti mbledhësh me një mbledhje të thjeshtë matematikore 3 muaj plus tre ditë plus 20 ditë bëjnë pak a shumë 4 muaj.

Eni Vasili: Pra ju thoni jeni aty për shkak të procedurave.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Unë kam menduar që do zgjaste rreth katër muaj dhe nga ai moment do fillonte procedura për përzgjedhjen e Prokurorit me mandate që do të kishte një kohëzgjatje të caktuar por natyrisht jo kaq.

Eni Vasili: A ju shoqërojnë ende pamjet e Parlamentit zonja Marku në momentin e betimit tuaj në Dhjetor 2017 siç e përmenda? Ju rilind në memorie flakadanët, goditjet me letra ,me çizme? Ka qenë një seancë jo e zakonshme. Në fakt ja pamjet, regjia po na i ofron .

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Në fakt është një moment që nuk mund të harrohet lehtë. Nuk jam e sigurtë nëse them që e kam harruar apo mund ta harroj. E shoh dhe e rishoh pasi transmetohet përditë në një nga mediat e nderuara dhe sa herë e shoh dhe rishoh, me thënë të drejtën admiroj veten për kurajon që pata për ta pranuar

detyrën në ato kushte të pazakonta. Unë kam qenë në një moment të vështirë në atë moment. Isha para një dileme të madhe, të vazhdoja të pranoja detyrën apo të tërhiqesha dhe koha për ta zgjidhur një dilemë të tillë ishte vetëm pak sekonda. Por unë e mora vendimin tim dhe nuk jam penduar në asnjë moment për zgjedhjen e bërë.

Eni Vasili: Një vit e gjysmë ndoshta nuk është shumë zonja Marku, por edhe pak nuk është. Nëse nga nesër nuk do të jeni më në këtë detyrë, çfarë do ti atribonit vetes? Cili është momenti më i mirë, çfarë keni bërë më mirë gjatë kësaj kohe në krye të Prokurorisë?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Është e vërtetë që një vit e gjysmë nuk është shumë, nuk është as pak. Në fakt, një vit e gjysmë është shumë mjaftueshëm për të shkatërruar diçka, por nuk është mjaftueshëm për të ndërtuar diçka, që mund të zgjasë në kohë dhe mund të duket. Megjithatë, unë mendoj që gjatë kësaj periudhe brenda kompetencave që më lejon Kushtetuta dhe Ligji, kam bërë gjëra që mund të mbahen mend. Ajo, që mund ta them me bindje është që për asnjë moment nuk kam përdorur funëksionet e mia për përfitime të asnjë lloji natyre. Kam ushtruar funëksionet e mia me paanësi të plotë dhe me ndershmëri të plotë dhe të kundërtën nuk mund ta dëshmojë askush. Gjithashtu brenda kompetencave të kufizuara që janë të karakterit administrativ, duhet thënë kam arritur të kurajoj, të motivoj prokurorët që të vazhdojnë betejën e tyre të përditshme me krimin pa u ndikuar nga askush, në paanësi të plotë, pavarësi të plotë e duke respektuar Kushtetutën dhe ligjet. Dhe mendoj që në shumicën e rasteve ia kam dalë, pasi ju jeni dëshmitarë që gjatë kësaj periudhe ka pasur mjaft çështje të rëndësishme që janë hetuar dhe kanë përfunduar në gjykatë.

Eni Vasili: Tek të cilat do ndalemi një e nga një. Shpresoj që të kem përgjigjet tuaja ashtu siç do ndalem dhe në akuzat që kanë shoqëruar punën tuaj.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Patjetër do të keni përgjigje për çdo gjë brenda kompetencave dhe limiteve të funëksionit tim.

Eni Vasili: Përpara se të fillojmë me bllokunë tjetër të pyetjeve që na çon më pas te dosjet e nxehta, akuzat e drejtëpërdrejta që keni patur etj etj, kam një pyetje të fundit përsa i takon kësaj pjese të parë . A ka diçka...ju thatë çfarë sipas jush keni bërë mirë. A ka diçka që ju do ta bënit ndryshe në vendimmarrjen tuaj ?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Një pyetje të tillë çdo profesionist ia bën vetes herë pas here, jam e bindur për këtë. Mirëpo, pa modesti mund ta them që edhe nëse do rikthehesha nga dita e parë, nuk kam gjëra që mendoj se i kam bërë gabim dhe mund ti ribëja ndryshe.

Eni Vasili: Dua të ndaloj tek kërsesa juaj për një mandat shtatë vjeçar. Zonja Marku, ju keni dorëzuar aplikimin për një mandat të plotë tashmë në KLP, institucion që më pas do merret dhe me renditjet e kandidaturave që do i shkojnë Kuvendit, një procedurë që është vendosur. Pyetja e parë që kam është kjo: Përse vendosët ju që të kandidoni për një mandat të plotë?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Siç është bërë publike edhe ju e thatë, kam dorëzuar aplikimin tim bashkë me dokumentacionin përkatës, për të garuar për një mandat të plotë. Përse e bëra? Unë mendoj që secili prokuror apo jurist nga jashtë sistemi, që plotëson kriteret që parashikon Kushtetuta Ligji, për të qenë Prokuror i Përgjithshëm duhet të kishte aplikuar, duhet të ishte bërë pjesë e garës, sepse një garë është shumë më e mirë dhe shumë më domethënëse nëse ka shumë kandidatë dhe shumë konkurrentë. Gjithmonë mundësia për të përzgjedhur një person cilësor është shumë më e madhe. Unë dorëzoja dokumentacionin dhe u bëra pjesë e garës pasi mendoj që kam punëuar mjaftueshëm për ta njohur mirë sistemin, për ta njohur mirë problematikën që ka Prokuroria. E kam të skanuar të gjithë sistemin në mendjen time dhe di çdo lloj problemi, dhe kemi filluar tashmë të marrim masa për të zgjidhur disa gjëra që nuk shkojnë mirë. Pra, jemi në proces dhe duke qenë në këto kushte mendova që unë mund ta bëj.

Eni Vasili: Ambicjet janë gjithmonë të mira, po ju jeni zgjedhur në krye të Prokurorisë me një mandat të përkohshëm zonja Marku, me 69 vota dhe gjatë kësaj kohe vlen të themi, drejtimi i Prokurorisë nga ana juaj apo dhe ju personalisht jeni shoqëruar me akuza nga opozita, kryesisht si një njeri i mazhorancës, njeri i Edi Ramës etj etj. A nuk do të kishte qenë përshembull një ide, për ti treguar të gjithë atyre që mendojnë në këtë mënyrë që mandati juaj ishte krejt i përkohshëm, pra të tërhiqeshit. E keni menduar këtë?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Ju mendoni që nëse nuk do kisha kandiduar do kishte pasur një tërheqje? Do ishin mbyllur gojët e liga? Jam e bindur që jo. Asgjë nuk do kishte ndryshuar. Do ishte nxjerrë një diçka tjetër, konkluzion tjetër. Megjithatë, unë nuk jam nisur fare nga ajo që mendojnë të tjerët. Jam nisur nga mendimet e mia, synimet e mia dhe jam bërë pjesë e garës.

Eni Vasili: Ju keni një vit e gjysmë në krye të Prokurorisë, siç e thamë. Nëse do të duhet të rendisnit një bilanc me tre gjëra kryesore, cili është bilanci i punës suaj?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Bilanci i punës time në këtë periudhë as të gjatë e as të shkurtër është i tillë: Po fillojmë që nga lëvizjet në krye të Prokurorisë, që u bënë në momentet e para që unë erdha në detyrë. Kam lëvizur nga detyra drejtues që mendoj që i kishin plotësuar orët e tyre në drejtim, që nuk kishin më se çfarë ti ofronin sistemit dhe për më tepër vetëm do vazhdonin të cënonin imazhin e gjithë sistemit në krye të prokurorisë.

Eni Vasili : Ju e keni quajtur një arritje këtë? Se ka të tjerë që e kanë quajtur një mangësi të punës tuaj.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Unë mendoj që në krye të Prokurorive, aty ku kam bërë lëvizje, kam venë njerëz cilësor, njerëz të ndershëm. Është cilësi shumë e rëndësishme të jesh i ndershëm dhe ata njerëz që unë i kam venë në drejtimin e Prokurorive i kam njohur si të tillë. Kam marrë dhe opinione të organizmave.

Eni Vasili: Akuzat janë që keni vendosur miqtë tuaj apo të njohurit tuaj, bashkëpunëtorët tuaj. Rasti zonjës Prela përshembull, për të jeni atakuar mjaft. Unë i kam të renditura më pas si pyetje, por meqenëse ju e hapët këtë kapitull.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Zonja Prela nuk është e vetmja drejtuese që unë kam caktuar përkohësisht gjatë periudhës që kam qenë në krye të institucionit, ka dhe disa të tjerë. Më duhet tju sqaroj paraprakisht që kompetenca për te caktuar drejtues në mënyrë të përkohshme apo për të lëvizur prokurorë nga një prokurori në tjetrën në mënyrë të përkohshme, ka qenë një kompetencë e parashikuar në një dispozitë kalimtare, dhe këtë kompetencë Prokurori i Përgjithshëm mund ta ushtronte deri në krijimin e KLP-së, pasi pas krijimit të KLP-së dihet tashmë që është KLP-ja që i bën këto lëvizje. Dispozita ishte një e vetme dhe parashikonte vetëm të drejtën e Prokurorit të Përgjithshëm për arsye të funksionimit të sistemit, të bënte caktime të përkohshme të Prokurorëve.

Eni Vasili: Dispozita thotë nëse nuk gaboj, pika 4 apo jo? Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Po flasim për KLP-në dhe Prokurori i Përgjithshëm mund të vendosë caktimin në pozicione të përkohshme të magistratëve për të mundësuar ushtrimin e detyrave dhe funksionimin e Institucioneve të drejtësisë.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Pikërisht! Kjo është pika përkatëse e dispozitës kalimtare, që më jepte të drejtën dhe kompetencën për ta bërë një gjë të tillë. Siç e shihni dhe vetë nuk ka një procedurë që duhej ndjekur në këtë rast, pra nuk ka kritere, nuk ka garë nuk ka asnjë lloj procedure dhe zgjedhja ishte në diskrecionin e Prokurorit të Përgjithshëm. Natyrisht që nuk janë zgjedhje abuzive. Janë zgjedhje të bëra pas marrjes së informacioneve në institucionet kryesore që ofrojnë informacion dhe pas verifikimeve në këtë institucion unë kam bërë caktimet e tyre

Eni Vasili: Cili do të jetë ylli polar që ju mendoni nëse pra ju do merrni mandatin? Ylli polar që do ju drejtojë në këtë mandat 7 vjeçar; motoja juaj; ideja juaj; synimi?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Secili prej kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm ka pasur detyrimin që në momentin që ka aplikuar të ketë përgatitur një strategji të qartë, një plan veprim të qartë, me një vizion të qartë për mënyrën se si parashikon ta drejtojë institucionin dhe ku do ta çojë institucionin në rast se merr mandatin. Natyrisht që unë kam një vizion se ku dua ta shoh Prokurorinë pas 7 viteve

nëse do kem një mandat. Dhe vizioni im është Prokuror të Pavarur por të përgjegjshëm. Kjo është sfida më e madhe që ka përpara Prokurori i Përgjithshëm, në momentin që do të zgjidhet.

Eni Vasili: Përveç Kushtetutës, Ligjit që një jurist, një prokuror, një gjyqtar e vë në pedestal dhe si frymëzuesin kryesor. A keni një frymëzim ju apo një model që ju do ndiqni në punën tuaj të Prokurorisë? Nëse do ta merrni mandatin e kam fjalën.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Natyrisht që do udhëhiqem nga Kushtetuta nga ligjet e dala në zbatim të saj, nga marrëveshjet në fuqi. Nuk mund të them që kam një model të tillë. Ka ikur koha e modeleve, secili bën modelin e tij.

Eni Vasili: Zonja Marku, përveç jush në garën për kreunë e Prokurorisë së Përgjithshme janë dhe prokurorët: Fatjona Memçaj, Gëzim Allushaj, Olsian Çela. Ç'mendoni për konkurrentët e tjerë në garë?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Paraprakisht po ju them që 2 nga konkurrentët i kam pasur shokë klase. Kemi qenë në të njejtën klasë në shkollën e Magjistraturës.

Eni Vasili: Që janë?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Olsian Çelaj dhe Fatjona Memçaj. Kandidatin tjetër nuk e njoh për hir të vërtetës. Për të dy kandidatët e tjerë që unë i kam pasur shokë klase kam vlerësim maksimal për anën profesionale të tyre. Nuk kam asgjë tjetër për të thënë.

Eni Vasili: Ndërkohë mendoni që do jetë një garë e fortë mes jush?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Mendoj që po. Secili prej nesh i plotëson kriteret. Janë të gjithë prokurorë dhe juristë cilësorë me çfarë kam parë dhe për kandidatin tjetër që nuk e njoh, do jetë një garë e fortë.

Eni Vasili: Olsian Çelën e keni transferuar, do vij më pas te dosjet e nxehta dhe te debatet për dosjen Shullazi e çfarë ndodhi me Prokurorët.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Nuk e kam transferuar.

Eni Vasili: Nëse nuk gaboj..

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Nuk kisha të drejtë të transferoja askënd.

Eni Vasili: Ka marrë një masë disiplinore, një transferim.

Prokurori i Përgjithshëm znj Arta Marku: Jo nuk është ashtu.

Eni Vasili: Si qëndron e vërteta?

Prokurori i Përgjithshëm znj Arta Marku: Është caktuar përkohësisht në Prokurorinë e Beratit por nuk është transferuar, është caktuar përkohësisht.

Eni Vasili : Ky është një tog fjalësh për të thënë...Caktim Përkohësisht ...

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Jo, jo, e lexuat vetë dispozitën.

Eni Vasili: Dakort, por është transferuar.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Transferimi është definitiv, të paktën për një periudhë të gjatë kohore. Pra, është caktim i përkohshëm dhe në çdo moment mund të ndërpritet.

Eni Vasili: Pra, caktimi i përkohshëm nuk është një masë disiplinore, nuk është ndëshkues?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Jo. Nuk është masë disiplinore dhe nuk është bërë për një arsye të tillë.

Eni Vasili: Ok. Do kemi mundësi ta detajojmë më pas çka ndodhur më pas me grupin e Prokurorëve e çështjen Shullazi, kur të flasim për dosjet e nxehta. Qëndrojmë tek synimi juaj për të marrë mandatin 7 vjeçar zonja Marku. Në fakt, Kryeprokurori i ri dhe e citoj në bazë të ligjit “zgjidhet nga Parlamenti me 35 e votave pasi këtij të funëdit ti shkoj lista me kandidaturat nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë nga KLP-ja”. Mendoni se do keni mbështjetjen e mazhorancës aktuale, mazhorancës së majtë, partisë Socialiste, duke pasur parasysh dhe faktin që edhe detyrën e Prokurores së Përgjithshme të Përkohshme e morët me votat e tyre.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Nuk e mendoj një gjë të tillë. Nuk e kam menduar. E rëndësishme është që të listohem në tre të parët. Do ishte mirë të isha e para, por nuk e kam menduar një gjë të tillë, nuk mund ta them.

Eni vasili: Mendoni të arrini të jeni e para në listë?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: E shpresoj.

Eni Vasili: A mendoni se në Kuvend me deputetët e opozitës së re, mund të arrihen 84 vota për emërimin tuaj?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: As këtë nuk mund ta them.

Eni Vasili: Në bazë të Kushtetutës, neni 148, gërma A, pika 4, se dhe unë i kam studiuar këto ditë, duket ndonjëherë që flas si ju.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: E shoh. E shoh.

Eni Vasili: Flas si ju tani. Nëse Kuvendi nuk plotëson votat e duhura, pra 84 vota, Prokurori i Përgjithshëm zgjidhet ai që është rënditur i pari siç thamë në listën e Prokurorisë. Do donit të zgjidheshit kështu, në këtë mënyrë; në këtë formë, dhe mendoni që do ta keni të lehtë?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Mendoj që është shumë më mirë zgjedhja në këtë mënyrë.

Eni Vasili: Është më mirë?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Po.

Eni Vasili: Opozita thotë se KLP-ja herë pas here ka nuanca të kapjes nga mazhoranca. Ju do donit ta komentoni këtë.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Nuk kam asnjë koment për të bërë për këtë. Përbërja e KLP-së dihet. Pesë janë të zgjedhur nga jashtë sistemit, janë zgjedhur nga Politika dhe gjashtë të tjerë janë pjesë e sistemit dhe janë produkt i një procesi votimi nga prokurorët, nga masa e prokurorëve. Kështu që nuk mund të thuhet që është e kapur.

Eni Vasili: Zonja Marku, meqë jemi te KLP-ja, kam vetëm dy vërejtje përpara se të kalojmë dhe në hapësirën e parë publicitare. Pak muaj më parë, në Janar të këtij viti, Autoriteti për Informin mbi Dosjet e Ish Sigurimit Të Shtetit deklaroi se anëtari i KLP-, Sheshi, kishte qenë bashkëpunëtor i sigurimit të shtetit. U ankimua në gjykatë. Gjykata e shpalli të pavlefshme në muajin Prill. Keni një koment mbi këtë situatë, e cila është shoqëruar me debate të mëdha publike?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Po, në fakt do të doja të bëja një sqarim publik, meqë mu dha rasti, në lidhje me këtë situatë. Për prokurorin Bujar Sheshi është bërë një kërkesë për verifikimin e tij nëse ka qenë pjesë e sigurimit të shtetit nga ana e Prokurorit të Përgjithshëm, por nuk ka qenë i vetmi kandidat për të cilin është bërë një kërkesë e tillë. Kërkesa është bërë për të gjithë kandidatët që garonin për të qenë pjesë e KLP-së. Por janë bërë në kohë të ndryshme sepse kandidati Bujar Sheshi hyri në garë në një moment të mëvonshëm .

Eni Vasili: Në fakt debati ka qenë ky, që Prokuroria ka qenë ajo e cila e ka favorizuar për shkak të kohës.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Jo nuk qëndron një gjë e tillë. Unë po jua shpegoj. I është bërë një kërkesë Autoritetit Të Dosjeve për gjithë të tjerët. Natyrisht afati është i shkurtër, është vetëm 7 ditë për verifikimet dhe kandidatët, ndër ta e dhe Bujar Sheshi, kanë qenë të detyruar të bëjnë një deklaratë kundëdrejt përgjegjësisë ligjore, që nuk janë pjesë e sigurimit të shtetit, nuk janë pjesë e shërbimit informativ apo shërbimeve sekrete dhe ca deklarata të tjera kundëdrejt përgjegjësisë ligjore për vërtetësinë e tyre. Kështu që, duke pasur një deklaratë të tillë dhe në munëgesë të përgjigjes, nga administrata e Prokurorit të Përgjithshëm është bërë verifikimi, është menduar që janë plotësuar të gjitha kriteret e është hapur gara dhe duhet të ju kujtoj në këtë moment dhe situatën, në të cilin ishte sistemi në atë kohë. Nuk ishte krijuar ende Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i cili ishte prioritet në atë moment dhe përderisa plotësoheshin kriteret, pra kriteret në dukje, duhej ecur me procedurën.

Eni Vasili: E qartë. Megjithatë, Autoriteti Dosjeve nuk pajtohet me vendimin. Ka deklaruar se: Bujar Sheshi figuron si bashkëpunëtor i Ish Sigurimit në dy dokumente themeltare autentike të arkivave dhe kjo është arritur të provohet në gjykatë me prova, fakte të pa kundërshtueshme- thotë autoriteti. Si qëndron e vërteta sipas jush?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Unë nuk dua ti hyj kësaj pjese dhe nuk më takon sepse vendimi nuk është i imi. Unë kam bërë një kërkesë dhe vendimmarrja është e autoritetit që ka kompetencën për ta bërë këtë dhe ndjekjen në rrugë administrative të kësaj vendimmarrje është detyrë, detyrimi i Autoritetit. Unë kam qenë kërkuese me një shkresë dhe në momentin që më ka ardhur përgjigjia e kam përcjellë te Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

Eni Vasili: Në djeninë tuaj, a ka Prokuroria sot në përbërje të saj element që kanë bashkëpunëuar me Ish Sigurimin e Shtetit zonja Marku?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Mund të ketë. Nuk kam një informacion por dhe mund të ketë. Nuk përjashtohet mundësia që të ketë.

Eni Vasili: Por ju vetë nuk keni një informacion?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Jo nuk e kam një informacion të tillë.

Eni Vasili: Ok. Ndalemi këtu për publicitetin e parë dhe do të kalojmë menjëherë te Dosjet e Nxehta, që nga ato të zgjedhjeve të cilat janë në qëndër të diskutimit politik opozita 339, 184 por dhe dosje të tjera shumë të rëndësishme si përshembull ajo e Shullazit.

Eni Vasili: Rikthemi në studio në Open. Jemi me Prokuroren e Përgjithshme të Përkohshme zonja Arta Marku, e cila tashmë kërkon dhe një mandat shtatë vjeçar është në këtë intervistë të detajuar, mbi të gjitha për të treguar synimet e saj dhe punën në Prokurori. Dua të ndalem tani në dosjet e nxehta. Zonja Marku, ka disa të tilla. Kemi një datë të dekretuar nga Presidenti për zgjedhjet që është 30 Qershori. Kemi një krah politik që është opozita që thotë nuk mund të kemi zgjedhje pa u dënuar, hetuar më parë, blerësit e votave në zgjedhjet e kaluara. Dhe duke lënë menjandë akuzat politike e di që Institucioni që drejtoni është apolitik. Dua t'ju pyes: Cfarë ndodh me dosjen 339 ose më saktë me dosjen 339/1? Në publik tashmë prej kohësh janë shfaqur përgjime të eksponentëve të një grupi kriminal. Behet fjalë për Abdylajt në lidhje telefonike me Kryetarin e Bashkisë së Durrësit Vangjush Dako. Cfarë po ndodh me këtë dosje?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Para se të jap një përgjigje me qëllim që askush mos të zhgënjehet nga përgjigjia, do më duhet të prezantoj mënyrën se si funksionon sistemi i Prokurorisë. Me ndryshimet e funëdit të Kushtetutës, ato të vitit 2016 dhe me të gjithë ligjet që dolën në zbatim të Kushtetutës, tashmë të ndryshuar, ka ndryshuar e gjithë mënyra e funksionimit të sistemit të Prokurorisë. Prokuroria nuk është më një organ i centralizuar piramidal, pra që varet nga Prokurori i Përgjithshëm. Prokuroria është një sistem komplet i decentralizuar tashmë. Zot i çdo çështje penale janë prokurorët që e kanë atë çështje. Përgjigjen për hetimin, përgjigjen për zgjidhjen dhe japin llogari vetëm përpara gjykatës për vendimmarrjen e tyre. Prokurori i Përgjithshëm nuk ka të drejtë të kërkojë informacion të detajuar për çështjet. Nuk mund të marrë përsipër vetë hetime, nuk mund të hetojë. Madje në Prokurorinë e Përgjithshme nuk bëhen më hetime, nuk e ka kompetencën lëndore Prokuroria e Përgjithshme për të bërë më hetime. Ka vetëm të drejtën për të përfaqësuar çështjen në Gjykatën e Lartë dhe në Gjykatën Kushtetuese. Pra, shkalla e tretë e Prokurorisë, por nuk ka lidhje me hetimin. Kjo gjë duhet të bëhet e qartë njëherë e përgjithmonë.

Eni Vasili: Pra ju doni të thoni që nuk keni asnjë djeni për dosjen 339 apo 339/1?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Dijenia që unë kam për këto dosje është brenda kufijve që më lejon Kushtetuta, ligji, dhe gjithë sistemi tashmë i ndryshuar. Unë kam të drejtë të marr informacion, jo mbi mënyrën si po ecën hetimi i çështjes, pra mbi fakte të caktuara apo mbi detaje të caktuara. Informacioni që merr Prokurori i Përgjithshëm është i karakterit statistikor, ose lidhet me procedurat. Si po ecin procedurat? A po ecin procedurat? Respektohen afatet? Pse nuk përfunëdohen dosjet? Pra, pa detaje në lidhje me hetimin.

Eni Vasili: Po ja, pse nuk përfunëdon kjo dosje përshembull? Një nga akuzat e forta të opozitës është kjo, zvarritja e kësaj dosjeje.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Unë kam kërkuar informacion për të dyja këto dosje që ju përmendët dhe nuk ka as të madh e të vogël, që nuk jua di numrin këtyre dosjeve tashmë. Se si qëndron e vërteta për këto, kur kanë filluar? Pse nuk

përfunëdojnë? Kam marrë informacion, që këto dosje janë mbajtur për një kohë të gjatë vetëm me veprimin hetimor të përgjimit. Pra janë bërë përgjime bisedash pa funëd dhe asnjë prej tyre nuk është transkriptuar. Për ta thënë më thjeshtë asnjë prej tyre nuk është zbardhur në letër. Momentin që prokurori, që kishte këto çështje...

Eni Vasili: Përse sipas jush ka ndodhur kjo?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Ja se do e jap një argument për këtë. Në momentin që prokurori i kishte këto çështje u caktua përkohësisht në një prokurori tjetër, që ishte komplet një rastësi, dorëzoi dosjet dhe prokurorët që i morën, konstatuan që kishte një numër shumë të madh disqesh, që ishin të patranskriptuara. Vetëm për dosjen 339 kishte rreth 700 cd. 700 të patranskriptuara. Natyrisht që një volum i tillë punë është jashtëzakonisht i madh dhe këtë mund ta kuptojnë ata që merren me këtë punë. Nuk e di se sa e kuptueshme është për masën e gjerë. Pra në një cd mund të ketë me qindra e mijëra biseda, të cilat duhen dëgjuar me kujdes e hedhur në letër.

Eni Vasili: Orë, mijëra orë përgjime..

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Biseda. Numra të pafund të përgjuara.

Eni Vasili: Pra duhen disa vite që të transkribohen të gjitha.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Nuk dua ta them që mund të shkojë me vite nuk është e arsyeshme një gjë e tillë. Nga drejtuesja e Prokurorisë së Krimeve të Rënda janë marrë të gjitha masat që të gjithë oficerët e Policisë Gjyqësore të Prokurorisë së Krimeve të Rënda të jenë në dispozicion të këtyre dy çështjeve.

Eni Vasili: Do ju pyes më vonë. Më pas, a do rritet numri i Prokurorëve apo njerëzve që do merren me këtë dosje? Qëndrojmë. Ju thoni ka 700 cd të pa...

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Natyrisht. Një numër i madh punëonjësish për të bërë transkriptimin e tyre. Këtë po thoj, që drejtuesja e Prokurorisë së Krimeve të Rënda i ka marrë të gjitha masat dhe ka caktuar një numër të lartë të oficerëve të policisë gjyqësore që po merren me transkriptimin dhe janë duke ecur.

Eni Vasili: Sa është duke ecur? Sa është numri?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Katër, pesë oficerë. Nuk përbën rëndësi në fakt numri. Por ka një grup hetimor.

Eni Vasili: Po grupi hetimor në vetvete, është shtuar?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Ka dy prokuror. Nga një prokuror që e kishte çështjen, ka dy prokuror që po merren me secilën prej tyre dhe me një numër të madh oficerësh që po merren me transkriptimin e bisedave.

Eni Vasili: Me këto shtesa që ju keni bere, keni nje ide se kur mund të përfunëdonjë procedurat, transkriptimet, të gjitha? Se ju thoni kemi marrë masa. Për çfarë? Ka një deadline?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Me cilat shtesa?

Eni Vasili: Ju thatë që kemi shtuar njerëzit që traskriptojnë?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: I ka shtuar drejtuesja e Prokurorisë së Krimeve të Rënda.

Eni Vasili: Kur them ju..ai që ka kompetencën sigurisht.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Unë mendoj që tani puna aty po ecën. Megjithatë, unë dua ta bëj të qartë për opinionin publik që ato dosje nuk mund ti hetoj unë. Nuk e kam të drejtën për ta bërë një gjë të tillë. Nuk më lejon Kushtetuta, nuk më lejon ligji. Pavarsisht se më atribohet çdo gjë, unë nuk e kam një kompetencë të tillë. Mbase po ta kisha, do i kisha zgjidhur, por fatkeqësisht apo fatmirësisht nuk e kam një kompetencë të tillë.

Eni Vasili: Zonja Marku, përpara se të arrijmë këtu, kam një pyetje. Juve sapo na shpjeguat dinamikën e kësaj dosjeje, pra volumin e saj të madh. Ka qenë e qëllimshme fakti që ka pasur një dosje kaq delikate në duar, me këto volume të mëdha dhe nuk është ecur më shpejt deri tani?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Unë mendoj që nuk është lënë krejt rastësisht. Ky është mendim i imi që lidhet me disa fakte që janë konstatuar dhe mendoj që është mbajtur qëllimisht. Nuk ka asnjë veprim tjetër të kryer përveç përgjimeve. Pra nuk janë shoqëruar përgjimet me veprimet e kryera në kohën reale me vëzhgime. Ka lloj- lloj metodash nëse do ta hetosh një dosje e do ta kesh të suksesshme, dhe secili prej prokurorëve këtë e di mirë.

Eni Vasili: Ju thoni në mënyrë të qëllimshme. Nga kush? Nga Prokurori i çështjes?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Prokurori që e ka pasur.

Eni Vasili: I cili ka qenë i ndikuar politikisht sipash jush?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: I ndikuar pastaj politikisht apo me ndonjë ndikim të ndonjë natyre tjetër, nuk preferoj ta them. Por di që është mbajtur për një kohë shumë të gjatë, disqe të patranskriptuara. Çdo mendje e shëndoshë nuk e konsideron këtë një rastësi, pra një harresë. 700 CD nuk mund të harrohen sepse edhe nëse nuk do, të zënë sytë po ti shohësh përditë.

Eni Vasili: Ok. Por sipas opozitës ajo vazhdon akoma të zvarritet për arsye politike.

Keni një përgjigje për këtë?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Gjatë analizës vjetore që unë pata në Prokurorinë e Krimeve të Rënda, e kam ngritur një problem të tillë. Ju kam kërkuar prokurorëve, që jo vetëm këtë dosje, por çdo dosje që është e ndjeshme për opinionin publik, duhet hetuar në mënyrë të shpejtë, natyrisht pa cënuar cilësinë e hetimit . Duhet hetuar dhe u duhet dhënë një zgjidhje ligjore në mënyrën më të shpejtë të mundshme dhe ky është një detyrim, një detyrë që e kanë prokurorët e çështjes dhe unë nuk mund të bëj asgjë tjetër, vetëm ti inkurajoj dhe tu kërkoj atyre që të zbatojnë ligjin.

Eni Vasili: A është mbrojtur politikisht Vangjush Dako nga një arrestim i mundshëm, siç pretendon opozita ?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Unë nuk kam informacion se çfarë ka në ato dosje përveç informacionit që keni edhe ju që është bërë publik, kështu që nuk mund të them asgjë të tillë. Unë preferoj të pres përfundimin e çështjes.

Eni Vasili: Pra nuk jeni në dijeni apo jo nëse është përgatitur apo jo një mandat arresti i mëparshëm për zotin Dako?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Jo nuk e kam një informacion të tillë dhe nuk kam pasur asnjë lloj mënyrë ligjore për ta marrë një informacion të tillë.

Eni Vasili: Nga ato që ndodhen, ndoshta keni dëgjuar në media. Ka dalë në përgjime me anëtarë të një bande kriminale. Nëse do të kishte qenë dikush tjetër në vënd të zotit Dako, do ishte lëshuar për të një mandat arresti?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Nuk mund ta them një gjë të tillë. Unë ju thash që informacioni që kam është i tillë si informacioni që ka çdo anëtar i publikut. Kudo.

Eni Vasili: Zonja Marku, a ka zyrtarë të tjerë, politikanë të tjerë që dalin në përgjime në këtë dosje hetimore?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Më duhet të jua ritheksoj përsëri që nuk kam të drejtë të kem një informacion të tillë dhe duke mos pasur të drejtë nuk mund ta marr një informacion të tillë. Dhe nëse unë e kërkoj , prokurorët e çështjes janë të detyruar të mos ma japin një informacion të tillë.

Eni Vasili: E kuptoj, janë të detyruar të ju vënë në djeni për procedurat.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Nëse unë e kërkoj informacionin, janë të detyruar të më thonë arsyet se pse zvarritet.

Eni Vasili: Ju kanë dhënë një arsye të tillë dhe ju kanë premtuar nëse do e quajmë

kështu, një deadline? Keni një ide ju se kur do dalë në dritë kjo dosje?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Ata më kanë dhënë arsyet që unë ju dhash më lart. Pra, numrin e madh, volumin e madh të disqeve të pa transkriptuara dhe po bëjnë maksimumin. Kanë garantuar që po bëjnë maksimumin dhe nuk kam një afat. Do doja ta kisha por nuk e kam.

Eni Vasili: Nuk e keni. Ok. Një tjetër dosje e nxehtë që përmendet nga opozita zonja Marku, me të drejtë nëse pretendimet e saj qëndrojnë sigurisht, është dhe dosja 184 që ka pak a shumë këtë karakter. I referohet zgjedhjeve në zonën e Dibrës në vitin 2016. Me këtë dosje çfarë po ndodh zonja Marku? Nuk kemi asnjë njoftim, është më e bunkerizuar se sa dosja 339/1. Nëse ka dalë diçka në media nga kjo dosje, 184 duket krejtësisht e mbyllur.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Në fakt është një dosje me të njejtën problematikë si e para. Ka shumë CD të pazbardhura dhe aty, me qindra numra të përgjuar, por edhe në këtë rast fatkeqësisht të pa shoqëruar me ndonjë veprim tjetër hetimor. Edhe në këtë dosje e njejtë problematikë është, të njejtat veprime po behen. Po zbardhen CD.

Eni Vasili: Sa CD ka kjo dosje nese keni ndjeni?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Nuk ka volumin e këtyre, por ka një numër të lartë të CD-ve.

Eni Vasili: Pra vazhdon hetimi për këtë dosje?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Patjetër.

Eni Vasili: Se ska pasur asnjë njoftim përmbyllës.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Patjetër, se të dyja dosjet janë në hetim edhe prokurorët janë vazhdimisht të inkurajuar nga unë, që të përfundojnë hetimin pa cënuar cilësinë natyrisht.

Eni Vasili: Po grupin e punës për këtë dosje e keni rritur? Siç keni bërë dhe me..

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Edhe këtu, pavarësisht se është me një volum më të vogël, ka 2 prokurorë dhe disa oficerë të policisë gjyqësore, që po merren me hetimin e saj.

Eni Vasili: Nuk kemi një datë apo një afat të përafërt edhe për vendimin e kësaj dosjeje?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Nuk kemi një datë.

Eni Vasili: Në fakt 184 dhe 339 opozita i cilëson edhe si kutia e pandorës që kur të hapet do të nxjerrë shumë emra të lartë të mazhorancës, të përfshirë në shit-blerjen e votës.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Duken dosje shumë të rëndësishme. Është bërë një përgjim i vazhdueshëm dhe natyrisht që duhet të ketë material.

Eni Vasili: Por ju nuk keni ndjeni?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Nuk Kam. Nuk kam dijeni, se po jua përsëris. Nuk kam të drejtë ta kem informacion dhe prokurorët dhe nëse unë lajthis dhe jua kërkoj janë të detyruar të mos më japin një informacion të tillë.

Eni Vasili: Po a ndodh gjithmonë kjo? Se ne e dimë se jo gjithmonë ndodh kjo.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Këto janë mënyrat se si veproj unë. Kështu është.

Eni Vasili: Edhe këtu, në këtë dosje kemi zvarritje. Apo jo zonja Marku? Dosja 184 konkretisht procedimi me numër 184/ 2016 po bën gati tre vjet që është regjistruar.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Po. Po është e vërtetë.

Eni Vasili: Si ka mundësi 3 vite pa asnjë rezultat?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Ja që ka mundësi. Edhe zbulimi i gjithë kësaj zvarritjeje ishte rastësi, pasi edhe për këtë dosje në momentin që prokurori u caktua përkohësisht diku tjetër edhe kishte detyrimin për të dorëzuar dosjet, u konstatua një gjë e tillë. Pra që ishin dosje pa veprime.

Eni Vasili: Opozita akuzon gjithashtu sërish si 339 dhe 184 po zvarritet për arsye politike. Keni një përgjigje për këtë ?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Nga momenti që këto dosje janë marrë nga prokurorët e tjerë nuk ka arsye të mendohet që po zvarriten. Unë di që po punëohet intensivisht me to dhe shpresoj shumë që së shpejti të këtë vendimmarrje. Natyrisht që prokurorëve që kanë marrë dosjet së fundmi duhet tu jepet koha e duhur që të bëjnë hetimin.

Eni Vasili: A ka qenë e qëllimshme zvarritja e mëparshme sipas jush?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Siç e thash dhe pak më parë çdo mendje e shëndoshë ashtu do mendonte.

Eni Vasili: Përse ka ndryshuar sipas jush disa duar prokurorësh kjo dosje? Kjo është

dhe një nga akuzat e opozitës.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Nuk ka ndryshuar disa duar prokurorësh. Ka një prokuror. Në momentin që u caktua diku tjetër u mor nga dy prokurorë të tjerë.

Eni Vasili: Është problem kjo? Caktimi i prokurorëve të tjerë, apo ka qenë dhe ky një nga arsyet për ta përshpjeguar?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Unë nuk e mendoj këtë problem. Madje dosja u zhblllokua dhe po hetohet tashmë.

Eni Vasili: Unë ju pyeta pak më parë për afatet. Ju thatë nuk i keni.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Nuk i kam unë. Mbase prokurorët e çështjes mund ta kenë të kristalizuar idenë e tyre por nuk e kanë detyrim të ma thonë mua.

Eni Vasili: A keni të drejtë ju, tju vini afate?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Afatet i vendos ligji. Afati maksimal në momentin që ka një emër personi të rregjistruar apo person nën hetim, është 3 vjet.

Eni Vasili: Zonja Marku do dalin në dritë këto dosje?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Unë shpresoj shumë që të dalin në dritë. Prokurorët i detyrohen të gjithë opinionit publik, gjithë shoqërisë shqiptare që ti zbardhin këto dosje. Dhe unë shpresoj shumë që ta bëjnë këtë.

Eni Vasili: A do kemi lajme shpejt nga këto dosje nëse keni informacion? Do këtë persona nën hetim?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Nuk preferoj të flas në kohën e ardhme. Preferoj të flas në kohën e tashme dhe nuk mund ta them një gjë të tillë.

Eni Vasili: Ok. Prej disa muajsh, në Prokurori po hetohet edhe problematika e tenderit të Unazës së Madhe. Një tender i shume përfulur, 20 milion euro i fituar me dokumenta të falsifikuara. Pra, në ç'fazë janë hetimet? Mund të flasim për këtë dosje? Jam duke trajtuar dosje të cilat realisht e kanë mbizotëruar opinionin publik.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Patjetër.

Eni Vasili: Ka qenë një debat shumë i madh. Kemi banorët e unazës që janë ende në protestë. Problematikë shumë sensitive.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: E qartë. E mirëkuptoj edhe pyetjen. Madje

nuk do të ishte normale mos të pyetej për këtë. Kjo çështje është në hetim nga Prokuroria e Shkallës së Parë Tiranë, pra nuk është në Prokurorinë e Krimeve të Rënda. Është një çështje mjaft e rëndësishme, mjaft sensitive dhe duket që e ka prekur shumë opinionin publik. Për të gjitha arsyet që unë thashë më lart, nuk kam të drejtë të kem informacion të detajuar dhe nuk kanë detyrimin prokurorët të më informojnë në mënyrë të detajuar për hetimin dhe mënyrën se si po shkon ai. Edhe për këtë dosje nuk e kam informacionin e detajuar. Di që është një grup hetimor. Pjesë e grupit është dhe drejtuesja e Prokurorisë që po merret me hetimin. Është një dosje që i është dhënë rëndësia e duhur, po hetohet. Duhet pasur parasysh se dosjet kur janë komplekse, duhet mbledhur informacioni i shumtë. Duhet të jetë në konsideratë dhe fakti, që ky informacion mund të gjendet në një shtet tjetër dhe duhet marrë në format, kanalet ligjore dhe kërkon kohën e vetë që të administrohet e të jetë pjesë e dosjes.

Eni Vasili: Dakort. Çka është në vëndet e tjera e mirëkuptojmë. Po përshembull deri tani nuk është parë asnjë zyrtar i lartë shtetëror në dyert e Prokurorisë, me përjashtim të Afrim Qëndros. Së pari ish ministri Gjijnuri, nuk është parë në dyert e Prokurorisë. Ndonjë Zëvendës Ministër apo zyrtar tjetër i lartë, që mund të ketë dijeni për këtë çështje nuk është parë në dyert e Prokurorisë. Ndonjë drejtues i kompanisë që fitoi tenderin nuk është parë po ashtu. Si e shpjegoni ju këtë?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Në fakt ju thoni nuk është parë. Unë them nuk e di, sepse dhe mund të jenë thirrur, mund të jenë pyetur. Këtë e dinë vetëm prokurorët e çështjes dhe nuk do ishte keq që ndonjëherë pyetjet tu drejtoheshin atyre sepse tani janë...

Eni Vasili: Nuk do ishte keq që ata të përgjigjeshin në fakt.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Pyetjet tu drejtoheshin atyre dhe natyrisht edhe të përgjigjeshin.

Eni Vasili: Gazetarët e kronikës janë këmbëngulës dhe rrinë jashtë dyerve të Prokurorisë. Ju i njihni dhe e dini mirë.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Patjetër.

Eni Vasili: Nuk besoj që nuk kanë pyetur. Fakti është që ndoshta nuk përgjigjen.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Duhet pyetur direkt. Nuk duhet pyetur unë për këto dosje. Nuk i marr dot për ti hetuar. Do të doja shumë të kisha mundësinë ta bëja dhe të paktën të mbaja përgjegjësi për atë që bëja në të vërtetë.

Eni Vasili: E kuptoj. Zonja Marku a po përdor Prokuroria dy standarte kur vjen puna e hetimit të dosjeve të rëndësishme? Po ju parashtrij pyetjen time. Një shembull konkret janë dosjet 184 dhe 339 dhe kjo e Unazës së Madhe që zvarritet. Pra kemi zvarritje. E pranua këtu së bashku që ka patur zvarritje të qëllimshme ose jo për këtë

dosje. Ndërkohë për çështjen e hetimit për Lobimin Rus ku përfshihet këtë rradhë opozita, ka një tjetër qasje, një tjetër shpejtësi. Madje për këtë dosje është thirrur në Prokurori edhe Kryetari i Opozitës zoti Basha. Ju keni dalë, kur them ju, Prokuroria, ka dalë me një deklaratë. Meqë jemi te dosja citoj: “ Nga provat e administruara në dosje rezultojnë të jenë kryer dy pagesa në shumën 650 mijë dollarë për efekt lobimi SHBA, të cilat nuk janë deklaruar ligjërisht nga subjekti i partisë Demokratike”. Pra janë bërë verifikime edhe jashtë. Pra disa dosje që operojnë brenda vendit kryesisht në thelbin e tyre zvarriten, disa të tjera hetohen menjëherë. Ka këtu 2 standarte?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Është e vërtetë që përceptimi ky është. Dhe unë po të isha gazetarë në këtë mënyrë do e perceptoja. Por kthehemi prap tek pika zero. Te kompetenca që ka Prokurori i Përgjithshëm, tek kompetenca që ka çdo prokuror çështjeje, tek decentralizimi që ka ndodhur në sistem. Ju mbase e dini ose mbase dhe nuk e dini. Po jua them unë që në çdo zyrë prokurorie ka një kordinator për marrëdhëniet me shtypin që presupozon që çdo zyrë prokurorie ka të drejtë që të dalë vetë me deklaratat për shtyp aty ku mendon që duhet dalë. Kjo që ju cituat është e dalë nga Prokuroria e Tiranës. Nuk ka lidhje Prokuroria e Përgjithshme me një deklaratë të tillë. Ata e kanë vlerësuar që duhet ta bëjnë edhe e kanë bërë. Por, në analizën që është bërë në Prokurorinë e Tiranës unë kam tërhequr vëmendjen për bërjen e deklaratave të tilla. Nuk mund të dalë e të përgjigjet Prokuroria me deklaratat pas çdo ngacmimi që bëhet nga politika. Deklaratat duhen bërë aty ku vlerësohet se ka një interes për opinionin publik dhe jo për t'ju përgjigjur ngacmimeve të politikës. E kam bërë një vrejje të tillë, është publike.

Eni Vasili: Po patjetër. Por pyetja ime ishte një tjetër. Pavarësisht kompetencës si drejtuese e një oragni të rëndësishëm, vëreni ju këtu dy standarte? Kemi një çështje që hetohet e thirren të gjithë shpejt e shpejt dhe një çështje tjetër po kaq të madhe që përfshihen zyrtarë të lartë.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Nuk mund ta them një gjë të tillë. Dosja që ju thoni është thirrur e është pyetur Kryetari i Opozitës është një dosje që është prej kohësh në hetim nga ajo.

Eni Vasili: Po nuk ka tre vjet.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: T'ju them të vërtetën nuk e di se sa ka. Është prej kohësh dhe ajo, të paktën që nga momenti që unë jam në këtë detyrë.

Eni Vasili: Po ju jap një rast tjetër mos të qëndrojmë vetëm aty. Hetimet për tenderat në Ministrinë e Drejtësisë. Thirren për të dëshmuar 2 ish ministra: Petrit Vasili dhe Ylli Manjani, në Shkurt të këtij viti. Absolutisht të gjithë thirre, të gjithë pyeten, të gjithë nëse vërtetohen se kanë bërë diçka prapa hekurave. Duket se hetimi i këtyre dosjeve ka dy standarte. Pra kur janë të përfshirë ata të opozitës ata thirren të gjithë. Ato të mazhorancës zvarriten.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Mos arsyet duhen kërkuar tek mënyra se si secili prokuror bën punën e tij, tek strategjia që ka për të bërë një hetim të caktuar. Nuk duhen parë në këtë formë. Nëse do ishin thirrur të gjithë nga unë, pra disa do ishin thirrur disa të tjerë nuk do ishin thirrur. Pra të gjitha çështet ti kisha unë personalisht në hetim apo stafi i Prokurorisë së Përgjithshme, atëherë mund ta jepja një përgjigje të tillë, por jo në këtë rast.

Eni Vasili: Zonja Marku paraardhësi juaj fliste shpesh për arrestime. Në vjeshtë do kemi arrestime, në pranverë do kemi arrestime. Do dëgjoni për arrestime të bujshme. Në fakt vitet kaluan, arrestimet nuk ndodhën asnjëherë. Juve nuk ju kemi parë të artikuloheni për këtë çështje. Pse?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: As nuk keni për të më parë.

Eni Vasili: Për shkak të ndryshimit të kompetencave?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Për shkak të ndryshimit të kompetencave. Nuk bën hetim Prokuroria e Përgjithshme. Duke mos bërë hetim, natyrisht nuk ka kompetencë as të arrestoj njeri, as të ndaloj njeri, as të ngrejë akuza për njeri. Çështjet ne i përfaqësojmë në shkallën e tretë të gjyqësorit.

Eni Vasili: Po ju jeni në djeni nëse po hetoni aktualisht funksionarë të lartë shtetërorë apo ish funksionarë të lartë shtetërorë të përfshirë në raste korrupsioni?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Unë vihem në djeni për këto dosje në atë mënyrë që ju thash. Kur mbledhim të dhënat statistikore që janë të detyruar ti sjellin në Prokurori dhe kur kërkojnë ndonjë informacion për ndonjë çështje që bëhet publike. Pra informacion të karakterit procedural, afate, kohëzgjatje. Të këtij karakteri.

Eni Vasili: Pra, nëse unë do ju pyesja. A po hetoni aktualisht funksionarë apo ish funksionarë, cila do ishte përgjigjia?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Mund të them që dhe mund të ketë, por unë nuk kam djeni e nuk kam të drejtë të kem djeni. Prokurorët nuk kanë detyrë të më informojnë mua.

Eni Vasili: Cili është vlerësimi juaj për Adriatik Llallën në krye të Prokurorisë sigurisht, jo si person?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Nuk është etike, nuk më takon mua të flas për paraardhësin tim. Nuk mund ta bëj një gjë të tillë.

Eni Vasili: Në Prokurori. Për Prokurorinë nën drejtimin e tij .

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Është gjë e kaluar. Situatë e kaluar.

Eni Vasili: Po hetimi për Kryeprokurorin e atëhershëm vazhdon, zotin Llalla?

Prokurori i Përgjithshëm: Po. Në djetën time vazhdon.

Eni Vasili: Po zvarritet apo është në kohë?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Nuk mund të them që zvarritet pasi aty kam një djetë më të madhe, për shkak të kërkesave për letër porosi që i drejtohen autoriteteve të huaja dhe që kalojnë nëpërmjet zyrës time.

Eni Vasili: Çfarë po ndodh me këto dosje pra?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Nuk ka përgjigje nga autoritetet Amerikane dhe Gjermane të drejtësisë dhe janë të domosdoshme për çështjen.

Eni Vasili: Nuk ka ende përgjigje?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Nuk ka ende përgjigje.

Eni Vasili: Si justifikohet kjo mos përgjigje?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Nuk mund të jap një shpjegim për këtë. Letër porositë në përgjithësi vonohen.

Eni Vasili: Jeni në pritje apo thjesht është refuzur informacioni? Apo është një procedurë që vazhdon?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Jo nuk është refuzuar informacioni. Priten përgjigjet. Por secili shtet ka procedurat e veta dhe janë të ndryshme nga të tonat.

Eni Vasili: Për t'ju rilidhur me pyetjen që ju bëra më pak më parë për arrestimet. Kryesisht nëpër vjeshtën kërkohen këto arrestime. Atëherë fillon sezori ri parlamentar mediatik. Problemi është që nuk ndodhën kurrë, sidomos për peshqit e mëdhenj. Besoj ju kujtohet Ambasadori Amerikan, ish Ambasadori Amerikan, Donald Lu, Ambasadorja e BE, e kanë artikuluar këtë togfjalësh "peshqit e mëdhenj". As të mëdhenj as të vegjël. Nuk ndodhi asgjë.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Është artikuluar shumë në kohën që ishte ish Ambasadori në fakt. Është e vërtetë. Por unë besoj që rasteve të cilave ai u referohet, kanë gjetur zgjidhje. Është gjykata që flet, apo do flasë për këto.

Eni Vasili: Do këtë ndonjë peshk të madh përsa kohë ju jeni në detyrë si Prokurore e Përkohshme? Pastaj do shohim çdo ndodhje dhe në mandatin shtatë vjeçar që ju po kërkon.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Do presim. Do shohim. Nuk kam informacion, nuk jam e detyruar të kem, nuk kam të drejtë të kem informacion të kësaj natyre. Dhe prokurorët, se po e përsëris ca si shumë, nuk kanë një të drejtë të tillë dhe nëse unë e kërkoj.

Eni Vasili: Mendoni që është jo natyrale për ne ta dëgjojmë nga Prokurori Përgjithshëm këtë gjë.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Shik, të vish nga një sistem tërësisht i centralizuar natyrisht është e vështirë të kuptohet një gjë e tillë. Unë mirëkuptoj këdo që nuk e kupton apo nuk do ta kuptoj e përgjegjësinë e kërkon te unë. Por realiteti është ky. Ky është ligji.

Eni Vasili : A ndjeheni për shkak të kompetencave një Prokurore e Përgjithshme e Përkohshme jo shumë e fuqishme? Për shkak të këtyre kompetencave të reja në ndryshim nga paraardhësit tuaj Llalla etj me rradhë.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Nuk e kam një ambicje të tillë, nuk e kam një problem të tillë. Kompetencat janë ato që janë dhe secili zyrtar do funksionojë në bazë të kompetencave që ka. Nuk është në zgjedhjen time përcaktimi i kompetencave. Është ligjvënësi që ashtu ka menduar dhe natyrisht që pritshmëritë e publikut janë të larta. Kjo ka qenë vështirësia ime. Kompetencat janë të karakterit administrativ dhe të përmbushësh pritshmëritë e larta për hetim, gjykim, me kopetencia të karakterit administrativ, është e pamundur.

Eni Vasili: E kuptoj. A mund të na thoni diçka të re për dosjen, për hetimin e Rinasit zonja Prokurore? Se do ju pyes më pas për dosjet ku janë përfshirë disa ministra. Po qëndrojmë te grabitja, pastaj kalojmë te Ministrat.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: E rëndë.

Eni Vasili: E rëndë dhe e ka shokuar opinion publik.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Në fakt është vërtet një ngjarje e rëndë. Po hetohet nga Prokuroria për Krimet e Rënda me gjithë seriozitetin e duhur, me vëmendjen e duhur, me një bashkëpunim shumë të mirë me policinë e shtetit. Ajo dosje në këndvështrimin tim është pothuajse e zbardhur. Është punuar shumë mirë si rrallë herë. Kështu që unë përfitoj nga rasti të përgëzoj si prokurorët, ashtu dhe policinë e shtetit për punën e bërë në këtë rast.

Eni Vasili: Si rrallë herë e thënë nga drejtuesja e Prokurorisë është sa e mirë dhe e keqe.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Është fakt.

Eni Vasili: Pse këtë rradhë u punua kaq mirë?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Është përmirësim në vazhdim, qoftë i punës së prokurorisë, qoftë i policisë së shtetit.

Eni Vasili: Çfarë ndodh? Është vullneti i kujt që pengon? Se këtë rradhë kur doni të hetoni, hetoni.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Nuk është vullneti i penguar, është përmirësim e sipër i dikujt që ta bëjë të funksionojë e kam fjalën.

Eni Vasili: Vullneti juaj?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Jo vetëm i imi. Ka shumë aktorë që e bëjnë një sistem të funksionojë. Nuk funksionon një sistem i vetëm.

Eni Vasili: Një nga akuzat që ju është bërë këtë kohë është pikërisht që ju keni ardhur në krye të Prokurorisë për të mbyllur dosje të rëndësishme. Një prej tyre është ajo e ish ministrit Tahiri. Këtë kisha në mendje tju pyesja. Keni një qëndrim për këtë?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Që ditën që kam ardhur, për këtë jam akuzuar. Për qëllimin për ta mbyllur këtë dosje, për ta pushuar, për ta prishur, për ti kthyer pasaportën e lloj lloj gjërash të tilla që për mua nuk paraqesin asnjë lloj rëndësie. Por fakti që dosja eci, prokurorët e zgjidhën si menduan dhe asnjë prej tyre nuk mund të dalë e të thojë, që unë i kam thënë ndonjërit prej tyre zgjidhe në këtë formë apo në atë formë. Unë mendoj që ato akuza janë nul, janë pa vlerë. Ju e keni vënë re që nuk e përmënd më njëri.

Eni Vasili: Nuk mund të thuhet ,që çështja Tahiri nuk përmëndet. Unë e kam rënditur..

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Nuk e përmënd më njëri që ka pasur ndikim tim apo është shkatërruar apo është bërë prej meje.

Eni Vasili: Do ju pyes dhe në mënyrë të detajuar më pas. Se do të kaloj në një pjesë tjetër të pyetjeve të mia që ka të bëjë me transferimet dhe dosjet e tjera shumë të rëndësishme. Siç është ajo e Shullazit, mënyra se si u sollët me prokurorët etj. Por do të doja... Atëherë e bëjmë kështu. Kalojmë në një hapësirë publicitare dhe do vazhdoj t'ju pyes për këtë.

Eni Vasili: Rikthehem në studio me Prokuroren e Përgjithshme të Përkohshme, Arta Marku. Një intervistë që është pritur në fakt gjatë në media. Kjo zonja Marku, nga kolegët gazetarë dhe nga publiku. Edhe ju pasi kjo është realisht intervista e parë pas një

kohe shumë të gjatë në drejtim të Prokurorisë dhe dua të qëndroj në këtë moment zonja Marku tek disa problematika të disa dosjeve të tjera, përfshi edhe çështjen Tahiri. Dua tju pyes tani dy çështje konkrete, për të cilat ju gjithashtu keni marrë shumë akuza. Së pari dosja Shullazi. Çfarë ndodhi në Shtator 2018 zonja Marku në zyrat e Prokurorisë së Krimeve të Rënda, kur u thirr një mbledhje e posaçme për çështjen Shullazi ?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Shtatori 2018 përkon me fazën kur gjyqi kundër Shullazit, po i referohem në këtë mënyrë, pasi kështu njihet dhe në publik.

Eni Vasili: Kështu njihet në publik. Eshte mëse e kuptueshme.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Ishte në fazën e konkluzioneve përfundimtare. Që do të thotë, prokurorët do të shkonin me kërkesa përfundimtare, për dënim të të pandehurve. Gjatë kësaj periudhe, drejtuesja e Prokurorisë së Krimeve të Rënda merr në mënyrë të papritur një njoftim nëpërmjet postës zyrtare nga prokurori i çështjes, që nuk ishte në gjendje të mirë shëndetsore dhe nuk e dinte se kur mund të kthehej, kur mund të ishte i aftë për të dalë në punë. Për këtë arsye, drejtuesja e Prokurorisë së Krimeve të Rënda, për shkak të afateve që kishte çështja në fjalë, do të duhej të caktonte një prokuror apo një grup prokurorësh të tjerë për ta përfaqësuar çështjen në gjykim. Duke mos ditur pra siç e thash, afatin e kthimit të prokurorit të çështjes. Dhe për këtë arsye njoftoi prokurorët për të marrë pjesë në hedhjen e shortit, për të përzgjedhur prokurorin që do caktohej për të përfaqësuar çështjen në gjykim. Prokurorët u paraqitën në atë mbledhje dhe ishin të njoftuar se për çfarë ishte kjo. Nga drejtuesja e prokurorisë i ishte thënë që nuk do të ishin vetëm në këtë çështje, pasi ishte tepër voluminoze dhe po merrej në një moment të fundit që duhej vepruar shpejt. Por bashkë me prokurorin që do përzgjidhej me short do ishin dhe drejtuesit e seksionit dhe zëvendës drejtuesi i Prokurorisë. Megjithatë prokurorët, një pjesë e tyre nuk kanë pranuar që të bëhen pjesë e shortit dhe janë larguar në mënyre demonstrative.

Eni Vasili: Janë larguar me arsytimin që nuk ishte ligjore.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Janë larguar me arsytimin që ishte jo ligjore.

Eni Vasili: Do ta diskutojmë këtë. Qëndrojmë te mbledhja. U raportua për tone shumë të ashpra në atë mbledhje. Konflikt verbal midis prokurorëve dhe Drejtueses së Krimeve të Rënda.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Unë nuk kam qenë pjesë e mbledhjes. Kam marrë një informacion.

Eni Vasili: U fol dhe për një konflikt fizik.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Nuk e di këtë. Flitet shumë. Unë kam marrë një informacion zyrtar nga Drejtuesja e Prokurorisë së Krimeve të Rënda për çfarë

kishte ndodhur në atë mbledhje hap pas hapi dhe kam konsideruar mënyrën, se si janë sjellë prokurorët jo etike dhe jo ligjore. Për këtë arsye kam filluar hetim disiplinor për 10 prej tyre siç është bërë dhe publike .

Eni Vasili: Po dhe për tre prej tyre ju menduat transferimin përfshi dhe zotin Çela.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Folëm dhe pak më parë për këtë.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Të njëjtët prokurorë, të gjithë pra prokurorët edhe këta që refuzuan të marrin pjesë në shortin e çështjes së Shullazit, kishin marrë pjesë në shorte për të marrë në hetim dhe në gjykim një numër të madh çështjesh të tjera, që ishin dorëzuar nga njëri prej prokurorëve, që kishin qenë pjesë e dosjes së Shullazit dhe asnjëherë nuk kishin ngritur një pretendim për paligjshmëri të shortit, apo arsye që i nxorrën vetëm në këtë rast. Kështu që kjo është për të kuptuar, kishte diçka tjetër mbrapa kësaj apo prokurorët mendonin se ishte joligjore.

Eni Vasili: Çfarë kishte prapa kësaj? Mund të na e thoni?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Unë mendoj që për një arsye apo tjetër prokurorët për shkak të natyrës së çështjes u stepën dhe nuk e morën dot përsipër.

Eni Vasili: A mund të themi dhe të flasim troç nëse mendoni se ka patur presion nga objekti, pra nga Shullazi?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Jo, nuk mund ta them këtë.

Eni Vasili: Ndaj prokurorëve?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Sepse unë mund të them një gjë vetëm nëse ..

Eni Vasili: Ka patur frikë prej prokurorëve?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Vetëm nëse unë e di në rrugë zyrtare një gjë të tillë apo qoftë dhe në rrugë të tjera. Për presione të kësaj natyre, unë nuk jam vënë asnjëherë në dijeni dhe asnjë prej prokurorëve nuk e ka pretenduar as në mbledhje një gjë të tillë.

Eni Vasili: Po si ka mundësi atëherë që 10 prokurorë bëhen bashkë.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Ja që ka mundësi, nuk janë bërë bashkë. Secili ka vepruar në mënyrë spontane.

Eni Vasili: Jo, por me të njëjtën ide, pavarësisht kanë të njëjtën ide që nuk është një procedurë ligjore, është e rastësishme?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Dosja ishte e rëndësishme, nuk është se ishte dosje si gjithë të tjerat dhe do merrej kështu me një moskokëçarje. Patjetër që kishte rëndësinë e vet.

Eni Vasili: A ishte i drejtë pretendimi i prokurorëve që thoshin se dosjen duhet ta çojnë njerëzit që e kanë hetuar?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Unë pikërisht për këtë arsye ju thashë, që të njëjtët prokurorë kishin marrë pjesë në hedhjen e shortit, madje ishin ngarkuar dhe me dosje të tjera të këtyre prokurorëve që kishin qenë edhe pjesë e dosjes së Shullazit.

Eni Vasili: Pra pretendimi i tyre sipas jush nuk qëndron.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Pretendimi i tyre nuk qëndron, pasi nëse do qëndronte do kisha vlerësuar si të tillë. Nuk do kisha filluar hetim disiplinor për ta.

Eni Vasili: Siç thashë, ju morët edhe një masë tjetër që është transferimi për Besim Hajdarmatajn në Pogradec, Çela në Berat dhe Muhametaj në prokurorinë e Pukës. Së pari pse këto masa? Dhe jeni akuzuar që nuk kanë që qenë në tagrin tuaj këto transferime. Pra i keni realizuar të mbështetur në ligj.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Këto nuk janë masa. Janë caktime të përkohshme në bazë të asaj dispozitës që ju e lexuat në fillim të emisionit. Dhe janë bërë me qëllim që të funksionojë sistemi. Prokurorët janë dërguar në tre prokurori që kishin bërë kërkesa vazhdimisht për shtim të numrit të prokurorëve. Të paktën përkohësisht për të përballuar një ngarkesë të momentit. Prokuroria e Pukës, Prokuroria e Beratit edhe pas krijimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, kanë vazhduar të kërkojnë prokurorë dhe është fakt i njohur publik.

Eni Vasili: A nuk mund të transferohen prokurorët pa pëlqimin e tyre?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Prokurorët nuk janë transferuar, transferimi është një masë definitive ose në mos definitive, që projektohet të zgjasë.

Eni Vasili: Caktimi i përkohshëm pa pëlqimin e prokurorëve?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Ju e lexuat dispozitën, lexuat diku që ka një procedurë që prokurorët duhet të shprehin pëlqimin? Është në diskrecionin e Prokurorit të Përgjithshëm.

Eni Vasili: Përkohshmëria, edhe ju e thatë, do jeni e përkohshme po ndenjët një vit e gjysmë. Kjo përkohshmëri ka një fund për këta prokurorë, sepse një nga akuzat që ata bëjnë është pikërisht kjo. Sa është përkohshmëria?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Përkohshmëria është sa të zgjidhet situata emergjente që ka sistemi në atë moment. Dhe dua të theksoj këtu që vendimmarrjet e mia aty janë në proces, në gjykatën administrative të Apelit. Nuk ka një vendim ende të gjykatës Administrative të Apelit në lidhje me to. Edhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë që i ndërpreu këto caktime të përkohshme dhe ktheu prokurorët aty ku ishin, nuk është shprehur për paligjshmëri të vendimmarrjes time, për caktime të përkohshme. Madje e kundërta duhet thënë, por kanë vlerësuar që këto caktime të përkohshme në atë moment duhet të ishin ndërprerë. Një vlerësim të tillë mund ta bëja edhe unë nëse nuk do kishte KLP në këtë moment.

Eni Vasili: Prokurorët reagues në atë kohë për Birn zonja Marku, dhe thanë se nuk kanë kundërshtuar shortin por procedurën, mënyrën e hedhjes së tij duke e konsideruar atë, siç thamë pak edhe më parë, joligjore. Në mendimin tuaj a kanë të drejtë?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Këto janë lojëra fjalësh. S'kundërshtova shortin por procedurën. Në fakt aty mbledhja ishte për shortin, kishin marrë pjesë edhe në shorte të tjera të organizuara në rrethana të tilla, me dosje të tjera dhe nuk kishin ngritur asnjë pretendim të tillë. Nëse prokurorët do kishin marrë pjesë në short dhe pretendime të tilla do i kishin ngritur në mënyrë të duhur, pasi të kishin marrë pjesë në short, jam plotësisht dakort që pretendimet e tyre do ishin vlerësuar, por jo në këtë mënyrë. Prokuroria nuk funksionon kështu.

Eni Vasili: Prokurorët e krimeve të rënda, ndaj të cilëve është urdhëruar fillimi i hetimit disiplinor, kanë refuzuar të marrin pjesë në hedhjen e shortit për të përfaqësuar në gjykim një çështje shumë sensitive për opinionin publik, thoni ju në një deklaratë për shtyp, Shtator 2018. Apo jo? Po përshembull, Besim Hajdermataj deklaroi në atë moment se e kishte pranuar ta përfaqësonte dosjen. Apo jo?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Zoti Hajdermataj kishte një mënyrë tjetër të kundërshtimit për të marrë dosjen, kishte pretendime të një natyre tjetër; njëherë nuk e marr, njëherë unë dua ta marr vetëm..

Eni Vasili: Ai vajti dhe në gjykatë, në mos gaboj, në një seancë, ku kërkohet më tepër kohë, në mos gaboj?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Vajtja në një seancë ishte për ta shtyrë seancën, sepse nuk kishte akoma një ide nëse prokurori i çështjes do kthehej dhe kur do kthehej, pra nuk kishte një konfirmim.

Eni Vasili: Pra e pranoi zoti Hajdermataj? Mund të themi që në atë moment zoti Hajdermataj e pranoi?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: E dinte që do ishte vetëm për atë seancë dhe kjo është e ditur. E di dhe zoti Hajdermataj, e di dhe drejtuesja dhe është fakt, është dhe në dosje.

Eni Vasili: Ai vetë ka shprehur që nuk ka refuzuar, ka kërkuar kohë për këtë çështje.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Për atë çështje nuk kishte kohë, ajo çështje..luhej me afatin, nuk mund të rrezikohej që prokuroria të digjte një dosje për shkak të afatit..nuk mund të ndodhë.

Eni Vasili: A mund ti krijoni një ide publikut çfarë ndodhi realisht? Cila ishte arsyeja që bëri këta prokurorë omblok, pavarësisht se ishte një vendim personal, por u bënë 10, të merrnin një vendim të tillë? Nuk di a ka patur një precedent tjetër të ngjashëm?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Është një situatë e paprecedent, prandaj dhe aty duhej ndërhyrë me patjetër. Nuk mund të dështojë një çështje se nuk ka prokurorë. Funkzioni primar i prokurorëve është ushtrimi i ndjekjes penale dhe përfaqësimi i çështjeve në gjykim. Është një funksion në Kushtetutë, është një funksion i detajuar në të gjitha ligjet e dala në zbatim të Kushtetutës. Nëse një prokuror nuk shkon, nuk pranon të shkojë në gjyq, apo nuk pranon të marrë një çështje në hetim pa dhënë argumenta ligjorë dhe në formën e duhur ligjore, është një prokuror që bojkoton detyrën.

Eni Vasili: Dakort, po sipas tyre ata kanë disa arsye ligjore. Sipas jush nuk janë ligjore dhe pa hyrë në këto. Çfarë ka ndodhur realisht sipas jush? Pse?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Arsyet ligjore duhen trajtuar në formën ligjore dhe jo në atë formë.

Eni Vasili: Ka patur presion nga jashtë? Apo kanë qenë pakënaqësi të brendshme zonja Marku?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Jua thashë pak më parë, prokurorët nuk më kanë informuar në asnjë moment që kanë një presion nga jashtë. Dhe nuk mund të lija që një dosje të dështojë se nuk ka prokurorë për ta përfaqësuar. Ky do ishte dështimi im.

Eni Vasili: Zonja Marku, qëndrojmë edhe pak te dosja e Tahiri dhe kjo një dosje mjaft e rëndësishme. E thashë edhe pak më parë, nuk përfaqësohet sot në gjykatë nga prokurorët kryesorë që e nisën hetimin. Hajdermataj u shkarkua nga drejtuesit e Prokurorisë së Krimeve të Rënda afro një vitë më parë, Imeraj u emërua drejtuese e prokurorisë së Tiranës, Osmani u zgjodh në KLP dhe sot kemi një trup tjetër prokurorësh që merret me këtë çështje. Është normale kjo?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Nuk është e vërtetë një gjë e tillë, pra nuk është plotësisht e vërtetë. Prokurorë që kanë çështjen, kanë qenë pjesë e grupit hetimor. Janë tre prokurorë që kanë qenë pjesë e grupit prej gjashtë prokurorësh. Nuk besoj që janë pak për të përfaqësuar një çështje tre prokurorë, që e kanë pasur që nga

fillimi çështjen.

Eni Vasili: Zonja Marku, keni dalë përpara Komisionit të Ligjeve si kandidate për Prokurore e Përkohshme, keni deklaruar se Prokuroria është një institucion i cili kërkon vazhdimësi, vijimësi dhe se ju nuk do të vepronit si paraardhësi juaj me transferimet, duket në fakt sikur keni bërë pak a shumë të njëjtën gjë. Keni transferuar dosjet e rëndësishme që kanë prokurorë të tjerë.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Unë po them që se kanë prokurorë të tjerë, janë të njëjtët prokurorë.

Eni Vasili: Janë, por nuk janë kryesorët.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Kush e ndan që një prokuror është më kryesor se tjetri? Nëse ka një grup prokurorësh, drejtuesi i grupit është drejtuesi i prokurorisë, është natyrale ta mendosh një gjë të tillë, por të gjithë prokurorët aty kanë të njëjtën peshë, të njëjtin rol, nuk mund të flitet ashtu. Ju mendoni që prokurorët që e kanë çështjen aktualisht, janë më pak cilësorë se ata që ishin?

Eni Vasili: Jo nuk po them që janë më pak cilësorë, ata i janë bashkuar rrugës hetimit, nuk kanë qenë në dijeninë time, nuk kanë qenë që ditën 0 pjesë e hetimit, janë bashkuar më pas.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Janë. Dita zero apo dita 1, çfarë ndryshimi bëri? Janë pjesë e grupit hetimor që nga momenti kur aty janë bërë hetime të vërteta. Dhe këtë e them me bindje dhe mund të kërkonti informacion në çdo moment, ta merrni të vërtetuar zyrtarisht.

Eni Vasili: Që ditët e para të marrjes suaj, nga ana juaj e detyrës, keni patur një përplasje me prokuroren Rovena Gashi. Cila është arsyeja zonja Marku? Ju e shkarkuat atë dhe nga detyra e drejtoreshës së Marrëdhënieve me Jashtë, pastaj ka qenë në mos gaboj përplasia e parë në Prokurori sapo keni hyrë apo jo?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Nuk konsiderohet përplasje, është..

Eni Vasili: Dakort, vëreni ju emrin..

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Është larguar nga një detyrë dhe ka vazhduar të ushtrojë funksionin si prokurore në Prokurorinë e Përgjithshme. Ka ushtruar të drejtat e saj ligjore duke ankimuar vendimmarrjen në gjykatë dhe ju duhet të jeni në dijeni që këtë betejë e ka humbur dhe në Gjykatën e Apelit, pra vendimmarrja ime ka qenë e drejtë.

Eni Vasili: Ju e pezulluat dhe nga detyra e prokurorit, i pezulluat edhe bashkëshortin Gina.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Zbatova një detyrim kushtetues, duhet ta bëja se ishte Kushteta që e parashikonte një gjë të tillë.

Eni Vasili: Që ka të bëjë me?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Për te dy ishte filluar çështja penale nga Prokuroria e Durrësit. Ishte ngritur akuza për secilin prej tyre, njoftimi, komunikimi i akuzave ishte bërë i pamundur për shkak të mosdeklarimit të një adrese të saktë apo për shkaqe të tjera që nuk arrinte të shkonte dokumenti në dorën e tyre dhe për shkak se ata nuk janë përgjigjur asnjëherë thirrjes për tu paraqitur në Prokurori, për tu njohur me akuzën. Por kishte një çështje dhe kishte akuza të ngritura, dhe në këto raste është Kushtetuta që parashikon detyrimin për të bërë pezullimin e prokurorëve.

Eni Vasili: A ka urdhëruar gjykata, rikthimin e tyre në detyrë zonja Marku?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Gjykata ka arsyetuar disa prej...e ka “vlerësuar” me shumicë votash, jo në mënyrë anonime, e ka vlerësuar në mënyrë të ndryshme atë Nen të Kushtetutës, duke i konsideruar veprën penale për të cilin ishin akuzuar të dy prokurorët, si një vepër jo të rëndë.

Eni Vasili: Dakort, por kemi një vendim gjykate, që thotë që urdhëri juaj ka qenë i padrejtë dhe që këta dy persona duhet të kthehen në punë, pavarësisht se zonja Gashi më pas, pati problematikën e saj me vetingunë por bashkëshorti i saj, a duhet kthyer në detyrë?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Këtë e ka vendosur gjykata kthimin e tij në detyrë, ai duhet të ndjek procedurat ligjore që të kërkoj kthimin në detyrë. Duhet ti drejtohet zyrës së përmbarrimit.

Eni Vasili: Fakti që gjykata ka vlersuar urdhrin tuaj të padrejtë..

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Nuk më komplekson një gjë e tillë. Ju e dini shprehjen: “Dy jurist, tre mendje.” Nëse vendimet tona do ishin të pagabueshme, të paatakueshme atëherë nuk do kishim gjykatë.

Eni Vasili: Dua të qëndroj dhe pak te Prokuroria e Krimeve të Rënda. Pak kohë më parë ju ishit në këto institucione, në analizën vjetore, e thatë edhe këtu, deklaruat që kjo prokurori është kthyer në supermarket. Ishte një tog-fjalësh që ra sy. Çfarë doni të thoni me këtë zonja Marku?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Shitet dhe blihet informacion.

Eni Vasili: Kush ja shet kujt? Dhe çfarë fiton nga shitja?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Tani kjo është mëse e kuptueshme, nuk

ka nevojë ta detajojmë.

Eni Vasili: Te politika. Ku është tregu i informacionit nga Prokuroria? Kush e blen?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Kushdo që ka një inetrës. Mos përjashtoni median nga pjesën e tregut që dëshiron të ketë informacion.

Eni Vasili: Pra ju po thoni Media është jo vetëm ndërmjetëse, por edhe destinare.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Jo vetëm Media. Informacioni kërkohet të blihet nga kushdo që ka interes.

Eni Vasili: Media sigurisht që ka interes të ketë informacion nga Prokuroria, se është puna e saj. Por e ka në mënyrë abuzive për të përdorur këtë informacion politikisht ose në çdo mënyrë tjetër, pra është destinatar.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Ju po e shihni si po përdoret informacioni. Si po përdoret? A po përdoret politikisht?

Eni Vasili: E kujt është përgjegjësia për rrjedhjen e informacionit nga prokuroria zonja Marku?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Përgjegjësia është e atij personi që e nxjerr informacionin dhe në dijeninë time ka një hetim të nisur për nxjerrjen e sekretit hetimor.

Eni Vasili: Ju thoni: “Secili prej jush të nderuar kolegë e dini mirë se çfarë duhej bërë dhe nuk është bërë, se si janë mbajtur çështjet nëpër sirtar për tu përdorur sipas interesave të caktuara që ju i dini dhe i njihni mirë”. Keni deklaruar fjalën tuaj përpara prokurorëve të krimeve të rënda dhe jua citova. Po kjo çdo të thotë zonja Marku?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Ata të cilëve unë u jam drejtuar me këtë lloj mënyre, e dinë shumë mirë se çfarë do të thotë.

Eni Vasili: A mund ta shpjegoni dhe për publikun?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Folëm për mbajtje dosjesh pa veprime, për hetime të paplota, për hetime të zvarritura që nuk janë mbajtur rastësisht. Ka një qëllim që janë mbajtur. Pra kjo ka qenë arsyeja që unë jam drejtuar në atë formë.

Eni Vasili: Pra ju e dini që ka disa që e dinë. Po këta persona, mbajnë përgjegjësi për këto zvarritje?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Këta persona pajtohen.

Eni Vasili: Kush pajtohet zonja Marku?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Ka një hetim të nisur në Prokurori për Krime të Rënda, për nxjerrjen e sekretit hetimor. Në momentin që do përfundojë hetimi, atëherë do kemi një informacion që do ndahet me publikun. Pasi nuk e kam as unë një informacion të tillë.

Eni Vasili: Zonja Marku, a ka sot ende dosje që mbahen në sirtar për interesa të caktuara dhe çfarë mund të bëni ju në këtë drejtim?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Unë vazhdimisht kërkoj informacione sipas kompetencave që kam, çdo tre muaj, për gjendjen që ka sistemi. Jo të gjithë i janë përgjigjur këtij detyrimi ligjor për të sjellë informacion për hir të së vërtetës. Duhet thënë dhe që nuk është koha më e mirë për të qenë në krye të këtij institucioni. Është një periudhë reformimi rrënjësor. Është një periudhë kur prokurorët janë në veting, disa janë shkarkuar dhe kjo ka rritur ndjeshëm ngarkesën e të tjerëve. Kështu që është një periudhë goxha e vështirë dhe komplekse për të pasur rezultate të mira dhe të dukshme dhe është dhe mundësia të ketë dosje të tjera që janë pa veprime.

Eni Vasili: Zonja Marku keni thënë gjithashtu: “Mbani larg Mediat nga hetimi, gazetarët nuk duhet të jenë pjesë e grupit hetimor”. E keni deklaruar këtë gjë përpara prokurorëve. Por në fakt ligji parashikon një Prokuror të Posaçëm që duhet të mbajë kontaktet me Mediat.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Po kontaktet me Median mbahen. Media ka të drejtë të kërkojë çdo lloj informacioni.

Eni Vasili: Prokurori i mediave, unë di që ka një strukturë të posaçme.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Kordinatorë për marrëdhëniet me mediat, kështu e ka emërtimin konkret.

Eni Vasili: A ekziston kjo strukturë dhe është efiçente?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Patjetër. Është kjo strukturë në çdo prokurori të rretheve. Unë e përmenda edhe pak më lartë. Dhe ka detyrimin që tu përgjigjet kërkesave për informacion, ka detyrimin që të dalë, të bëjë deklarata publike, aty ku prokurorët e çmojnë se duhet bërë një deklaratë e tillë dhe çdo Prokurori e ka një kordinator të tillë.

Eni Vasili: Pse ju ka lindur nevoja që të bëni këtë deklaratë: “Gazetarët nuk duhet të jenë pjesë e grupit hetimor”? Në fakt kanë qenë?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Ju të gjithë e keni parë se si janë bërë emisione pa fund me procesverbalet e përgjimeve që kishin dalë nga dosjet në fjalë. Kështu që ajo mënyrë e trajtimit të informacionit nuk është korrekte.

Eni Vasili: Ndoshta nuk do ta dinim që këto dosje ishin zvarritur, nëse nuk do të kishim patur këto informacione publike zonja Marku. Apo jo?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Dosjet janë aty. Një prokuror as nuk i zhduk dot.

Eni Vasili: Nëse ne gazetarët nuk do i kishim nxjerrë në media askush nuk do e dinte që ekzistonin, do rrinin dhe 6 vjet aty ndoshta ato 700 CD.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Nuk e besoj.

Eni Vasili: Jeni dakort me mua?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Nuk jam dakort me ju. Media e keqpërdor informacionin. Unë nuk flas për të gjithë, nuk mund ti përgjithësoj. Ka gazetarë që janë shumë korrekt. I dinë limitet e detyrës së tyre dhe gëzojnë respektin maksimal për ata që e ushtrojnë detyrën e tyre në këtë formë.

Eni Vasili: A do të donit të veçonit dikë?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Natyrisht që jo.

Eni Vasili: Apo ndonjë ngjarje të veçantë që ka dëmtuar punën e Prokurorisë në këtë kuptim?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Jo, nuk dua të veçoj diçka të veçantë por e ripërsëris prapë. Gazetarët kanë të drejtë, kanë akses në informacion, për aq sa lejohet në ligj. Pra aq sa nuk cënohen sekretet hetimore dhe prokurorët kanë detyrë të japin informacion, duke mos cënuar sekretin hetimor. Një marrëdhënie e tillë duhet të jetë mes medias edhe Prokurorisë. Një marrëdhënie e tillë e shëndoshë, me limite të caktuara, me kufij.

Eni Vasili: Nëse do ishte kështu nuk do ishte hetuar apo nuk do kishte plasur asnjë skandal në botë zonja Marku.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Skandalet nuk i shërbejnë askujt.

Eni Vasili: Edhe pse unë e mirëkuptoj pozicionin tuaj, mendoj që gazetarët kanë detyrën të rrëmojnë aty ku të tjerët nuk futen dot, për të bërë të mundur që njerëzit e duhur të shkojnë përpara drejtësisë edhe skandalet të hetohen.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Patjetër, por unë prapë i qëndroj parimit tim që secili detyrën e tij duhet ta bëjë brenda kufijve që i lejohen.

Eni Vasili: Duke qenë gazetarë dhe në një pozicion tjetër, përgëzoj të gjithë gazetarët që mundohen të gjejnë pikërisht ato informacione me mënyrat e tyre, të cilat i shërbejnë publikut. Po këtu ne ndahemi në misionë dhe nuk ja vlen të bëjmë një diskutim. Kam një pyetje tjetër zonja Marku. Cili është raporti që ju keni me Donika Prelën?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Donika Prela është një drejtuese e caktuar përkohësisht nga ana ime, si shumë të tjerë. Kam një marrëdhënie shumë korrekte me të. Është një drejtuese që është përpjekur të bëjë maksimumin që nga momenti që ka marrë atë funksion. Kompetencat e kufizuara që kam unë, të kufizuara i ka dhe ajo në atë detyrë ku është. Dhe nuk është e lehtë të punohet me ato kompetenca dhe në atë lloj terreni. Unë mendoj që ka bërë maksimumin në krye të institucionit. Ka pasur çështje shumë të suksesshme aty dhe nuk është përgjegjësi e saj problematika e këtyre dy dosjeve që përmendëm pak më parë në emision.

Eni Vasili: E keni fjalën për 339 dhe 339/1?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Patjetër.

Eni Vasili: Flitet shumë. Më thoni nëse keni një miqësi personale me zonjën Prela. Ka qenë kjo arsyeja e transferimit të saj?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: E kam pasur shoqe klase. Ky është një fakt. Po të them unë jo, është një fakt që vërtetohet. E kam pasur shoqe klase në Magjistraturë siç deklarova që kam dhe dy kandidatët për Prokuror të Përgjithshëm. Kemi qenë në të njëjtën klasë.

Eni Vasili: A është shkak miqësia juaj personale për transferimin në krye të Prokurorisë së Krimeve të Rënda të zonjës Prela?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Nuk është shkak. Njohja ime me të më ka bërë ta njoh çfarë personi është çfarë përfaqëson dhe për ti besuar që të drejtojë atë institucion.

Eni Vasili: Zonja Marku, Prela u emërua në krye të Prokurorisë Krimeve të Rënda pasi drejtoi për disa muaj Prokurorinë e Durrësit, e thamë edhe në këto momente. Kur Prela ishte drejtuese aty ndodhën edhe ngjarje të rënda. Grabitet postieri Prokurorisë; vidhet Prokuroria; janë marrë dosje; është dëmtuar një server mos gaboj. A duheshin marrë masa?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Njëri prej episodeve ka ndodhur në kohën që ka qenë drejtuese Donika Prela, tjetri nuk ka ndodhur në kohën që ka qenë ajo drejtuese. Kanë ndodhur në kohë të ndryshme.

Eni Vasili: Si shpjegohet kjo?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Ju mendoni që ka një lidhje me..

Eni Vasili: A duhet të mbajë dikush përgjegjësi?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Ka dhe një çështje në hetim për këtë.

Eni Vasili: Nëse nën drejtimin tuaj ndodh diçka e rëndë ju mbani përgjegjësi, nuk është se promovoheni ?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Përgjegjësi morale por natyrisht duhet parë situata se ne ç'rrethana ka ndodhur. Aty ka një hetim, por nuk ka një përfundim të hetimit që ne të shohim se kush e ka fajin.

Eni Vasili: Edhe po zvarritet.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Pa autor. Jo nuk po zvarritet.

Eni Vasili: Nuk po zvarritet? Domethënë është brenda afateve kohore.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Është brenda afateve. Aty ka autor ka të dyshuar edhe na takon të flasim në momentin që do kemi një konkluzion.

Eni Vasili: E kuptoj. Si e vlerësoni ju punën e zonjës Prela në krye të Prokurorisë së Krimeve të Rënda?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: E thash dhe pak më parë, është përpjekur të bëjë maksimumin. Aty ka pasur mjaft raste të suksesshme. Është zhbllokimi i çështjes Shullazi. Janë arrestuar anëtarë grupesh të strukturuar kriminale siç i kemi parë për çështjen e trafikut të vizave, për trafik droge. Çështje nga më të ndryshmet. Janë dhe pjesë e raportit vjetor konkluzionet. Ka pasur një rritje për vitin 2018 të goditjes se grupeve të strukturuar kriminale dhe kjo patjetër nuk mund ti atribuohet dikujt tjetër.

Eni Vasili: Zonja Marku, po qëndroj dhe me 2-3 pyetje te zonja Prela, më pas kalojmë te një bllok tjetër që është Reforma në Drejtësi. Po qëndroj këtu se ka qenë le ta themi kështu, një thembër Akili për ju. Miqësia juaj gjithmonë duket se ju ka vënë gjithmonë në një binom dhe ju ka atakuar nëpërmjet zonjës Prela. Por unë dua disa komente tani për zonjën Prela nga ana juaj. Mënyra se si e kaloi zonja Prela vetingun solli reagimin e opozitës, e cila tha se KPK është një vegël e pushtetit. Besoj e kujtoni. Keni një koment për mënyrën si e kaloi zonja Prela vetingun?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Vendimmarrjen për zonjën Prela e ka dhënë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Unë kam një koment për të gjithë ata të cilët dalin dhe përpiqen të denigrojnë figurën, qoftë të zonjës Prela apo të çdo prokurori tjetër apo gjyqtari tjetër të sistemit. Nëse dikush ka diçka për një gjyqtar apo prokuror, le ta çojë informacionin tek KPK, tek KPA, por jo në këto forma. Këto janë forma denigruese, nuk janë forma që i shërbejnë vendimmarrjes së KPK-së apo KPA-së.

Eni Vasili: Pasi u pyet nga përfaqësuesi i OMN-së për mos pagesë takse zonja Prela tha :

-“Unë dhe bashkëshorti im kemi jetuar në Shqipëri dhe jo në vëndet e Bashkimit European”. Kjo është një nga frazat e atakuara.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Unë nuk kam asgjë për të thënë për mënyrën si është përgjigjur apo për pyetjet që janë bërë. Unë dua të sjell në mendjen tuaj faktin që përfaqësuesi i OMN-së nuk kishte asnjë lloj kundërshtie me vendimin e KPK-së. Dhe kjo do të thotë shumë.

Eni Vasili: Zonja Marku, ata që atakojnë këtë vendim thonë se një pjesë e madhe e prokurorëve janë shkarkuar nga detyra nga KPK, për gjetje shumë më të vogël se zonja Prela.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Unë nuk mund ta them këtë. Nuk e kam luksin unë për të bërë gjykime të kësaj natyre.

Eni Vasili : E kuptoj.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Kam qenë vetë pjesë e procesit. E di çdo të thotë të jesh në atë proces.

Eni Vasili: Çdo të thotë?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Nuk është fare e lehtë të jesh në atë proces. Dhe kushdo mund të flasë shumë i qetë me një kafe para për këdo, e kaloi ky, e kaloi ai. Por ata që janë pjesë e procesit e dinë mirë çdo të thotë. Askush nuk mund ta kuptojë po nuk ishte pjesë.

Eni Vasili : Pse nuk mund ta kuptojë? Mund ta ndani me ne.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Është e vështirë sepse periudha që kontrollohet është shumë e gjatë. Kërkohej informacion përpara 15 vitesh dhe të gjithë e njohim shoqërinë shqiptare se sa informale ka qenë dhe sa sa informale vazhdon të jetë. Kështu që vetëm kaq do ndaj me ju edhe besoj se është e mjaftueshme për të kuptuar se sa e vështirë është.

Eni Vasili: Dua të qëndroj te kriminaliteti. Është folur mjaft, ka patur ngjarje këtë kohë, qytete që kanë shqetësuar më shumë se të tjerët. Ndonjë vështrim të përgjithshëm shkurt. Si e vështroni gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri zonja Marku?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Rezultatet për gjendjen e kriminaletetit janë pasqyruar në mënyrë të detajuar në raportin vjetor të punës së Prokurorisë. Ka analizë të detajuar për çdo lloj veprë penale dhe çdo lloj grup veprash. Duhet thënë që rrethi me kriminalitetin më të lartë është Vlora. Kriminalitet të lartë paraqet edhe Shkodra, Elbasani dhe rrethe të tjera pastaj sipas numrit.

Eni Vasili: Zonja Marku në raportin e dorëzuar në Kuvend, për vitin 2018 mbi gjendjen e kriminalitetit në vend thuhet se veprat penale të kryera nga banda e armatosur dhe organizata kriminale janë 2.4 herë ose 14 përqind nëse nuk gaboj me një rritje, 141 përqind, me një rritje krahasuar me një vit më parë. Çfarë ka ndodhur që kemi këtë rritje?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Ky tregues nuk është tregues vetëm i rritjes së kriminalitetit. Ata që merren me statistika e kuptojnë mirë këtë punë. Ky është tregues

dhe i punës së mirë hetimore, punës së mirë zbulimore, punës së mirë te Prokurorisë dhe Policisë së Shtetit. Pra ndjekja penale e këtyre rasteve ka qenë më e suksesshme, jo se është rritur kriminaliteti. Pse mos ta lexojmë kështu?

Eni Vasili: Vepra penale të kryera janë rritur me 2.4 herë.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Kështu e thonë statistikat.

Eni Vasili: Të kryera jo të hetuara.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Të kryera domethënë të hetuara.

Eni Vasili: Cili është qyteti më pak i sigurt në Shqipëri zonja Marku?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Ne i kemi renditur në bazë të të dhënave që ka secila Prokurori. Është dhe në bazë të ngjarjeve. Vlora në mos gaboj.

Eni Vasili: Pra më pak i sigurti është Vlora?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Jo më pak i sigurti për të jetuar, por që ka një kriminalitet të lartë, krahasuar me numrin e banorëve.

Eni Vasili: Çfarë po ndodh në Vlorë sipas jush? Pse kjo renditje?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Asgje që nuk ka ndodhur më përpara. Nuk mund ta them arsyen se pse. Ka shumë faktorë që mund të ndikojnë në një problematikë të caktuar në një moment të caktuar. Asgjë nuk ndodh rastësisht, asgjë nuk ndodh pa shumë faktorë.

Eni Vasili: Zonja Marku çfarë po ndodh në Shkodër atëherë? Është një tjetër qytet, i cili këtë kohë ka tronditur opinionin publik me ngjarje të veçanta. Nga fillimi vitit të shkuar kemi një seri ngjarjesh kriminale të rënda. Vrasje, shpërthime mes qytetit të cilat nuk janë zbardhur. Faji i policisë, i prokurorisë edhe pse ky është një top në fakt që njëherë shkon këtë njëherë andej.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Jo nuk e shoh në këtë formë. Unë e shoh që në Shkodër ka një bashkëpunim shumë të mirë të prokurorisë me policinë. Aty ka çështje mjaft të suksesshme. Ka pasur zbulueshmëri të disa rasteve që kanë ndodhur vjet, pra në 2018 dhe në 2019. Mund të them që është punuar shumë mirë. Kjo është meritë e drejtuesit të Prokurorisë së Shkodrës dhe prokurorëve të Prokurorisë së Shkodrës dhe gjithashtu dhe e policisë së shtetit aty. Ka një koordinim mjaft të mirë të punës mes dy institucioneve.

Eni Vasili: Koordinimi është i mirë por kemi raste të pazbardhura akoma.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Unë preferoj të qëndroj te rastet e zbardhura. Raste të pazbardhura do ketë gjithmonë, do ketë dhe do punohet në vazhdimësi për ti zbardhur.

Eni Vasili: Edhe Elbasani është.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Vrasja e fundit përshembull ju e dini se u zbardh. Pati persona të arrestuar për këtë.

Eni Vasili: Elbasani është një qytet ku duket se zbardhja e ngjarjeve është thuajse e

pamundur. Po të numërojmë vrasjet e atentatet pa autor, e kuptojmë që situata nuk është normale aty. Apo jo ?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Në fakt aty nuk është bërë punë kaq e mirë sa është bërë në Shkodër. Dhe unë nuk mund të drejtoj gishtin diku. Ka mjaft për të bërë qoftë nga policia qoftë nga Prokuroria aty. Institucionet duhet të bashkëpunojnë më shumë, duhet të koordinojnë më shumë, duhet të përdorin edhe Institucionet e tjera Ligjzbatuese për informacion në kohë reale. Por mesa di unë, aty është ngritur në grup pune, një Task Forcë me përfaqësues të të gjithave institucioneve. Pjesë e këtij grupi është dhe drejtuesi i Prokurorisë së Elbasanit dhe mendoj që situata mund të përmirësohet.

Eni Vasili: Zonja Marku, ka patur ndërhyrje politike të cilat kanë vështirësuar zbardhjen e ngjarjeve? Në Elbasan përshebull? Në dijeninë tuaj?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Në dijeninë time jo.

Eni Vasili: Vetëm pak kohë më parë në qendër të Elbasanit u vra një avokat i njohur Ravik Gurra. Keni një koment për këtë ngjarje dhe në çfarë faze janë hetimet? Nëse keni informacion.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Është një ngjarje shumë e rëndë dhe uroj mos të përsëritet kurrë një rast i tillë. Çështja është në hetim në Prokurorinë e Krimeve të Rënda dhe për arsytet që i thash dhe i rithash, nuk kam informacion në lidhje me mënyrën se si po ecin.

Eni Vasili: Zonja Marku si e vlersoni ecurinë e tanishme në Reformën Drejtësi? Po ecën me hapat e duhura?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Mund të them që..

Eni Vasili: Edhe pse kur them Reformë në Drejtësi, duket sikur nënkuptojmë Vetingun.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Po në fakt është një nga aspektet më të rëndësishme të së gjithë reformës.

Eni Vasili: Atëherë po jua bëj pyetjen kështu. Në këndvështrimin tuaj, a ka prokuror që nuk duhet ta kalonin Vetingun dhe që e kanë kaluar apo anasjelltas?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Reforma në Drejtësi është një nga reformat më rrënjësore që ka ndodhur ndonjëherë në Shqipëri. Është një reformë që ka ndryshuar siç ju thashë, terësisht mënyrën se si funksionon sistemi i Prokurorisë. Është një reformë që parashikon një proces të rivlerësimit të të gjithë prokurorëve, gjyqtarëve që janë pjesë e sistemit. Pra, duhet të kalojnë në Veting të gjithë prokurorët dhe gjyqtarët këtu për tu rikonfirmuar ose jo në detyrë. Është një reformë që duke qenë kaq thelbësore, kaq rrënjësore, kaq e shumëanshme, natyrisht që kërkon kohën e saj për tu zbatuar dhe implementuar. Unë mund ta them me kënaqësi që rezultatet e para të reformës kanë

filluar të duken. Janë ngritur institucionet e para. Është ngritur Këshilli i Lartë i Prokurorisë, nga i cili do varet krijimi, përzgjedhja e prokurorëve për Spak, nga i cili do zgjidhet Prokurori i Përgjithshëm me mandat. Është krijuar Këshilli i Lartë Gjyqësor, nga i cili do zgjidhen antarët e gjykatës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Është ngritur dhe funksionon Këshilli i Emërimeve në drejtësi, i cili ka për detyrë dhe shumë shpejtë do ta konkludojë zgjedhjen e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Të dyja këto institucione janë...

Eni Vasili: Ti po ecën shpejt. Po ne jemi akoma pa Gjykatë të Lartë, pa Gjykatë Kushtetuese. Jemi në një situatë totalisht jo normale për një shtet apo jo?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Jemi.

Eni Vasili: Duhet ta pranojmë këtë gjë.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Një shtet pa Gjykatë Kushtetuese nuk mund të konceptohet të funksionojë. Ne kemi Gjykatë Kushtetuese por nuk e kemi funksionale. Le ta shohim gotën gjysmë plotë, jo gjysmë bosh. Por shumë shpejt antarët e Gjykatës Kushtetuese do jenë të zgjedhur. Unë jam pjesë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe e di që aty po punohet fortë dhe procedurat po ecin. Dhe jemi, jam shpresë plotë që do jemi shumë shpejt me anëtarët e zgjedhur.

Eni Vasili: Po jua ribëj pyetjen, në këndvështrimin tuaj ju thatë shumë shpejt, kur? Kemi një kohë?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Jemi në procedurë. Zoti Vorani, në një nga takimet e fundit që u bënë, me sa kujtoj me komitetin e Helsinkit, tha që brenda Majit ne do dalim me emra dhe do i propozojmë nëpër institucionet përkatëse të emërtesës. Kështu që le ti referohemi zotit Vorani që është dhe kryetari i këshillit.

Eni Vasili: Si pjesë e procesit besoni se mund të jetë e mundur brenda Majit? Jemi në Maj.

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Ne nesër kemi një mbledhje, pasnesër për hir të së vërtetës, dhe do shikojmë se ku jemi me përgjigjet e institucioneve që kanë detyrime të na kthejnë përgjigje shkresave që ne kemi dërguar për të verifikuar kandidatët.

Eni Vasili: Po e bëj dhe njëherë pyetjen, në sistem sipas jush kanë ikur njerëz të vlefshëm që duhet të rrinin dhe kanë ndenjtur ata që nuk duhet të rrinin, keni një vlerësim për Vetingun?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Unë mund të them që të gjithë prokurorët e gjyqtarët që janë pjesë e sistemit, e njohin shumë mirë njëri tjetrin. Nëse kanë ikur persona që duhet të iknin apo që kanë qëndruar persona që nuk duhet të qëndrojnë, është KPK-ja, është KPA-ja që e vlerëson. Ka institucione që janë qenë të ngritura enkas për këtë dhe një opinion i tillë është shumë personal dhe unë nuk mund ta

ndaj me ju.

Eni Vasili: A është sot Prokuroria, drejtësia më e pastër dhe më e besueshme se sa para të niste reforma?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Fatkeqësisht ende jo. Reforma vazhdon, jemi në fillimet e saj. Procesi i vetingut është në fillimet e tij, ka një numër të vogël të personave që kanë kaluar në atë sitë, por ka një numër tjetër prokurorësh dhe gjyqtarësh që e njohin shumë mirë veten, e dinë çfarë përfaqësojnë, e dinë që nuk do e kalojnë kurrë sitën e vetingut dhe po punojnë jo mirë dhe po çenojnë rëndë besimin e publikut në sistemin e prokurorisë dhe sistemin gjyqësor. Kështu që, për sa kohë këta persona vazhdojnë, nuk mund të jetë një sistem më i pastër.

Eni Vasili: Ju thatë pak më parë që ata që e dinë se çdo të thotë të kalosh në Veting e dinë që është e vështirë. Me sa duket e keni përjetuar po kështu me vështirësi edhe ju. Keni pasur frikë nga “vetingu”, për ti dhënë një konotacion?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Jo për hir të vërtetës nuk kam pasur asnjëherë frikë. E di se si kam punëuar, i di pasuritë që kam dhe janë të deklaruara, kështu që mjafton ti referohesh fakteve dhe kuptohet pastaj nëse unë duhet të kisha frikë apo jo.

Eni Vasili: E prisnit vendimin?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: E prisja vendimin. Asnjëri prej nesh nuk e ka vendimin surprizë. Ne para se të na caktohet seanca na vjen konkluzioni nga KPK-ja, ku përcaktohet qëndrimi i tyre, gjetjet e tyre dhe nëse kërkohen prova nga ne, përcaktohet në atë relacion. Dhe për fat të mirë, unë nuk kam pasur nevojë të paraqes prova të reja. Është bërë relacioni, më është nisur relacioni dhe nuk kam pasur barrën e provës për asgjë.

Eni Vasili: Kur e dinit që kishit një përgjigje pozitive, pse nuk vajtët vetë atëhere? Kjo ka qenë një nga pyetjet e shumta. Pse nuk u paraqitët në Veting, por nëpërmjet avokatit tuaj?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Ishte e vetmja gjë për të cilën jam penduar. Duhet të kisha shkuar vetë, por nuk u ndjeva shumë mirë për ta përballuar aty. Ka qenë vendimmarrje e çastit dhe e pamenduar mirë mbase.

Eni Vasili: E kuptoj. Dakort, unë jam në fund dhe kam vetëm pak minuta kohë të cilat do dua ti shfrytëzoj për disa pyetje personale zonja Marku. Edhe kur hyra ndava me publikun një koment, thashë më në fund një grua përballë në këto intervistat e rëndësishme, kokë më kokë, pasi janë kryesisht burra dhe pyetja ime është kjo: Sa e vështirë është për një grua, për një nënë, nënë e dy vajzave, njëra ende e vogël, vajza e vogël është jo më shumë se dy vjeç, të drejtojnë një organ kaq të rëndësishëm siç është organi qendror i akuzës së një vendi?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Për çdo grua është më e vështirë mendoj unë të paktën, se sa për një burrë, të bëj çdo lloj detyre, jo më detyra të tilla të kësaj rëndësie. Pasja e dy fëmijëve, e vështirëson nga njëra anë, por nga ana tjetër një femër ndihet shumë më e plotë, shumë më e motivuar, shumë më me dëshirë për të punëuar mirë, për të patur rezultat të mirë dhe për ti shërbyer familjes nëpërmjet punës së saj. Kështu që unë ndjehem shumë e motivuar, pavarësisht faktit që nuk është e lehtë.

Eni Vasili: Nuk është e lehtë sepse nuk jeni prezente? Sepse puna ju merr shumë kohë? Sepse çështjet janë të një rëndësie që ju detyron që të kaloni stresse apo situata të pakëndshme? Përse?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Puna është e tillë që merr natyrisht shumë kohë. Unë përpiqem që të mbaj ekuilibër përmes familjes dhe punës, pra sa është e mundur. Ka periudha kur kjo është e pamundur për hir të vërtetës dhe gjithmonë peshorja anon nga puna, por gjatë gjithë aktivitetit tim mundohem që të mbaj një ekuilibër, pra aty ku është e mundur unë të jem pranë familjes. Dhe kjo arrihet duke shfrytëzuar maksimalisht çdo moment, duke shfrytëzuar kohën dhe duke e organizuar mirë.

Eni Vasili: Por realisht sa kohë ju merr puna e përditshme dhe si arrini ta organizoni?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Puna e përditshme nuk ka orar, këtë mund ta them. Nuk është 8 me 4.

Eni Vasili: Është 8 me..?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Nuk ka orar. Në varësi të problematikave që mund të ketë një moment i caktuar, pikërisht.

Eni Vasili: E ndiejnë vajzat këtë? Ju kërkojnë më shumë? ju thonë kur do vish në shtëpi?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Natyrisht që e ndiejnë, por unë kam ndihmën e familjarëve të mi. Kanë gjithë dashurinë e gjyshëve, të babait patjetër.

Eni Vasili: E kuptoni që ky dedikim, në qoftë se do merrni një mandat të plotë 7-vjeçar do jetë akoma më i madh dhe ndarja do jetë akoma më e vështirë. E keni marrë parasysh këtë?

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Nuk është se do ndryshojë. Madje unë mendoj që do jetë në përmirësim sepse vajzat po rriten. Duke u rritur pastaj, nevoja për të pasur pranë mamanë zvogëlohet.

Eni Vasili: Zonja Marku, unë ju falenderoj që ishit me mua, që ndatë të gjitha komentet dhe informacionet që mundët për teleshikuesit dhe sigurisht ju uroj suksese në garën tuaj!

Prokurori i Përgjithshëm Zj. Arta Marku: Faleminderit!